

DELIRJE DHE EDUKIM | fq. 4

SIGURIA DHE VLERA
E SAJ NË ISLAM | fq. 12

RËNDËSIA E AMANETIT DHE
NXITJA PËR RUAJTJEN E TIJ | fq. 18

VLERA E LËMOSHËS
NDAJ TË VARFËRVE | fq. 30

Dëlirje & Edukim

KORRIK 2011 | REXHEB - SHABAN 1432 | NR. 27 | ÇMIMI 1€

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE

SI TË SHFRYTËZOJMË PUSHIMET VERORE

Dikush mendon të vizitojë familjarët, dikush tjetër mendon të lexojë diçka, dikush mendon të merret me kurse dijeje, të cilat janë intensive në ditët e verës, por fatkeqësisht dikush mendon se në cilin bregdet do të kalojë pushimin duke i bërë mëkat Allahut të Madhëruar. Të paktë janë ata që kujdesen që gjatë pushimit veror të mësojnë leximin e librit të Allahut apo të mësojnë dije fetare dhe të afrohen me të sa më afër praktikimit të dispozitave islame. **fq. 2**

Thuaju: "Zjarri i Xhehenemit është edhe më i nxehtë!" Veç sikur të kuptonin!" *Tevbe 81*

Libraria Vlera

Gjilan

Libraria Vlera, (përballë Fakulltetit të Edukimit) Gjilan




Në librari kemi edhe literaturë për huazim dhe lexim të tyre...

*"Nxitoni drejt faljes së gjynahere nga. Zoti juaj dhe Ahenetit,
hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur
për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në
mirëenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin
dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit."*

Allu Imran 134-135

DOLI NË SHITJE LIBRI



KOMENTAR I LIBRIT RIJADU SALIHIN

NGA DIJETARI:
MUHAMED IBEN SALIH EL UTHEJMIN
VËLLIMI I PARË



Kryeredaktor:

Unejs MURATI

Zv. Kryeredaktor:

Mr. Fidan XHELILI

Anëtarët e revistës:

Adem AVDIU

Sabahudin SELIMI

Xheladin LEKA

Bashkëpunëtorët:

Bali SADIKU

Fehmi DALIPI

Lirim SADIKU

Namik VEHAPI

Shuajb REXHA

Eshrefedin ISMAJLI

Redaktor gjuhësor:

Arian KOÇI

Boton:

Shtëpia botuese

Atik

Gjilan, Republika e Kosovës

Tirazhi: 1000

Adresa:

Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan

Republika e Kosovës

E-mail: delirjedheedukim@gmail.com

PËRMBAJTJA

EDITORIALI

Unejs MURATI

Si të shfrytëzojmë pushimet verore 2

Muhamed Nasirudin ALBANI

Dëlirje dhe Edukim 4

Dr. AbduRrezak EL BEDER

Pastërtia e zemrës dhe e gjuhës 8

Dr. AbduRrezak EL BEDER

Kush është i fituari? 10

Dr. Abdul Adhim BEDEVII

Siguria dhe vlera e saj në Islam 12

Dr. Salih ibën Fevzan El FEVZAN

Ekstremizmi ashtu siç është në teprim është edhe në
lëshim 16

Dr. Abdurrezak EL BEDER

Rëndësia e amanetit dhe nxitja për ruajtjen e tij 18

Sabahudin SELIMI

Ne dhe morali i të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem 22

Darul Vatan

Më e mira që është thënë për ty motër (II) 26

Salih ibën Ta Ha ABDULVAHID

Vlera e lëmoshës ndaj të varfërve 30

Adem AVDIU

Hyrja në tualet dhe pastrimi pas jashtëqitjes 37

Muhammed ibën Salih el UTHEJMIN

Pastrimi dhe namazi i të sëmurit 42

NDIHMO REVISTËN

Nr. i llog.: 1150-138922-0101-09

ProCredit Bank of Kosovo

Swift Code: MBKORS22

Gjilan, Republika e Kosovës

SI TË SHFRYTËZOJMË PUSHIMET VERORE

"Nuk do përqendrohen këmbët e robit Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për katër gjëra: jetën e tij si e kaloi, trupin e tij si e shfrytëzoi, pasurinë e tij nga e fitoi dhe ku e harxhoi si dhe dijen e tij si e praktikoi."

Muslimani gjithmonë duhet të ketë si synim ngritjen në çdo pjesë të jetës, të shpresojë më të mirën, më të dashurën, më të çmuarën, ngase ka me vete një armë madhore, ka ndihmën e Allahut të Lartësuar, i Cili i ngre njerëzit e devotshëm.

Vitet kalojnë njëri pas tjetrit, kurse natyrshmëria e njeriut kërkon shfrenim dhe shejtani sillt vërdallë duke kërkuar shpirtra të dobët që mashtrohen pas tij. Fillimi i pushimeve verore i gjen të gjithë duke menduar për vendin e duhur për kalimin e këtyre ditëve të lira nga puna dhe presionet e përditshme gjatë gjithë vitit. Duke e parë si momentin e duhur, njerëzit mendojnë si t'i kalojnë ditët larg problemeve dhe stresit të përditshëm. Dikush mendon të vizitojë familjarët, dikush tjetër mendon të lexojë diçka, dikush mendon të merret me kurse dijeje, të cilat janë intensive në ditët e verës, por fatkeqësisht dikush mendon se në

cilin bregdet do të kalojë pushimin duke i bërë mëkat Allahut të Madhëruar. Të paktë janë ata që kujdesen që gjatë pushimit veror të mësojnë leximin e librit të Allahut apo të mësojnë dije fetare dhe të afrohen me të sa më afër praktikimit të dispozitave islame.

Koha në jetën e muslimanit është shumë e shtrenjtë dhe ka vlerë të madhe, prandaj muslimani shpreson fitore dhe arritje të të mirave në të gjitha sferat, qoftë në atë të imanit apo në çështjet e kësaj bote. Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Dy gjërave njerëzit nuk ua dinë vlerën: shëndetit dhe kohës së lirë."*

Shëndeti është mirësia më madhore që i ka dhënë Allahu njeriut, e ka krijuar në formën më të mirë, por pakkush ia di vlerën, pos atëherë kur e humbin dhe sëmuren.

Koha e lirë është kulmi i pasurisë: nëse e shfrytëzon, ke fituar e nëse e anashkalon, ke humbur.

Shfrytëzimi i kohës është në dorën tënde, andaj ti o musliman shfrytëzoje në të mirën tënde, në atë që të sjell dobi në dunja dhe në ahiret.

Çdo njeri është përgjegjës para Allahut për humbjen e kohës së tij, ndërsa Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

"Nuk do përqendrohen këmbët e robit Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për katër gjëra: jetën e tij si e kaloi, trupin e tij si e shfrytëzoi, pasurinë e tij nga e fitoi dhe ku e harxhoi si dhe dijen e tij si e praktikoi."

Nëse prindërit nuk kujdesen për kohëne fëmijëve të tyre, atëherë rreziku që ata ta shfrytëzojnë në mënyrë negative është shumë e madhe.

Mosshfrytëzimi i kohës mbjell përtaci, edukatë të ulët, mungesë ambicieje për një të ardhme më të mirë dhe më të frytshme, preokupim duke menduar se si ta shfrytëzojë kohën në diçka që e hidhëron Allahun e Madhëruar.

Mënyrat e shfrytëzimit të kohës në periudhat e pushimit:

a. Leximi i Kuranit

E gjithë kjo manifestohet duke mësuar leximin e Kur'anit për atë që nuk e di leximin e këtij libri të madhëruar, duke ia bërë obligim vetëm mësimin e tij përmendësh, duke i mësuar fëmijët që pushimet verore t'i kalojnë çdoherë në adhurime të tilla dhe duke i larguar nga shikimi i shumtë i TV-së si dhe degjenerimeve që po u ofrohen fëmijëve përmes tyre

b. Kurset verore/piknikë

Regjistrimi në kurset e ndryshme studimore, si mësimi i kompjuterit, i gjuhëve të ndryshme, lëndëve dhe mësimëve që të

sjellin të mira gjatë shkollës që ti vendos të vazhdosësh pas pushimeve, andaj ti nënë dhe ti baba mundohu që fëmijën tënd ta dërgosh në vende kuai përfiton.

c. Vizitat

Vizitat tek të afërmit, d.m.th. farefisi, duke mos i ndërprerë lidhjet farefisnore mes tyre, vizita të të sëmureve, qofshin ata në shtëpitë e tyre apo edhe duke u bërë vizita të sëmureve nëpër spitale.

d. Kuize të ndryshme dhe gara dijeje

Kuize të ndryshme, qofshin ato familjare, pra kuize brenda familjes tënde, që të testoni dijen çdo ditë apo çdo javë.

Këto kuize mund të jenë të llojeve të ndryshme, duke filluar nga kuize në çështjet fetare deri në lëndët e përgjithshme.

Nuk ka të keqe nëse del në piknik dhe bëni kuize të tilla gjatë piknikut.

Në fund, e lus Allahun e Madhëruar që të na mëshirojë me mëshirën e Tij të plotë, të na e bëjë të mundur ta shfrytëzojmë kohën dhe gjithashtu këshilloj dhe rikujtoj çdo nënë, baba, djalë dhe vajzë me fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Allahu do të pyesë çdo përgjegjës dhe bari kopeje, nëse ka ruajtur dhe edukuar mirë apo e ka humbur atë."*

Unejs MURATI

Gjilan / Kosovë



DËLIRJE & EDUKIM

"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë) dhe kapeni për bishtat e lopëve (pas pasurisë së kësaj bote), jeni të kënaqur me të dhe e lini xhihadin (luftën), ka për të zbritur Allahu nënçmim mbi ju (dhe nuk e ngre atë) derisa të riktheheni në fenë tuaj."

Më të vërtetë falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Sot jemi duke jetuar në një kohë shumë të rëndë dhe të zezë për muslimanët, të cilët janë të nënçmuar e të udhëhequr nga të tjerët. Kjo që na ka goditur, ky nënçmim që ka zbritur mbi botën islame, bën që secili prej nesh edhe pse me nivele të ndryshme- të pyesë shpesh, publikisht apo në një rreth më të ngushtë, për shkakun që i solli muslimanët në këtë gjendje kaq të mjerë. Po kaq shpesh pyesim edhe për ilaçin e kësaj gjendjeje, se si të shpëtojmë nga ky nënçmim dhe mjerim. Më pas ndryshuan mendimet, u shpeshtuan vërejtjet dhe secili mbështeste metodën apo rrugë që pretendonte se ofronte zgjidhjen dhe shërimin e kësaj dileme.

Them se këtë problem e ka përmendur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke e cilësuar në disa hadithe të vërteta dhe duke qartësuar shërimin e saj.

Mes këtyre haditheve është fjala e tij: *"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë) dhe kapeni për bishtat e lopëve (pas pasurisë së kësaj bote), jeni të kënaqur me*

të dhe e lini xhihadin (luftën), ka për të zbritur Allahu nënçmim mbi ju (dhe nuk e ngre atë) derisa të riktheheni në fenë tuaj."^[1]

Në këtë hadith të shkurtër gjejmë sëmundjen që ka përfshirë muslimanët. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem përmendi dy lloj sëmundjesh si shembull e jo si numërim.

Lloji i parë është zhytja e muslimanëve në mëkate, duke u mashtruar prej tyre, edhe pse e dinë një gjë të tillë. Kjo është e fshehur në fjalën e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem "nëse bëni tregti (merreni me kamatë)". El a'inetu, siç dihet nga librat e fihkut, është një lloj shitblerjeje që në hadith përshkruhet si e ndaluar. Megjithatë, shohim disa dijetarë që e lejojnë shitblerjen me këtë formë:

Dikush blen nga tregtari diçka, për shembull një makinë, dhe e paguan me këste për një kohë të caktuar. Pastaj blerësi i makinës ia shet të njëjtën makinë po këtij tregtari me çmim më të ulët, por pagesa bëhet me para në dorë menjëherë dhe tregtari i parë, që tani është blerës, e paguan çmimin e saj me para në dorë, por me çmim më të ulët sesa kur e shiti makinën më herët me këste dhe për

[1] Es Sahiha, 11.

kohë të caktuar. Për shembull, supozojmë se çmimi i makinës është 10000 lira dhe blerësi e shet atë pastaj për 8000 lira me para në dorë tek i njëjti tregtar prej të cilit pak më parë e bleu për 10000 lira. Dallimi prej 2000 lirash i llogaritet shtojcë në pagesën e tij, e kjo është kamatë.

Kjo shtojcë është kamatë. Muslimani që dëgjon fjalën e Allahut të Madhëruar dhe hadithet e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për ndalesën e kamatës obligohet të mos e pranojë dhe lejojë këtë lloj shitblerjeje, derisa ka shtojcë në pagesë (nëse merret me pagesë me këste). Disa njerëz e lejuan një gjë të tillë meqë këtu ka blerje dhe shitje, duke u argumentuar me argumentet e përgjithshme që lejojnë blerjen, siç është fjala e Allahut: *"E Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën."* El Bekare: 275.

Ata thanë se kjo është blerje dhe shitje e nuk ka të keqe nëse e ngre apo ul çmimin.

Mirëpo qëllimi kryesor i blerësit është të blejë për 10000 lira me këste e pastaj të njëjtin produkt ta shesë për 8000 lira me pagesë kesh që të përfitojë marrjen kesh të 8000 lirave pasi e dinte se tregtari nuk i jepte borxh 8000 lira, që t'ia kthejë 8000 për hir të Allahut. Por tregtari do më shumë, atëherë ky blerës bëri një mashttrim duke e lejuar këtë lloj shtojce në emër të shitjes.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është qartësues për njerëzit, ashtu siç ka thënë edhe Allahu i Madhëruar në Kuran: *"Ty ta zbritëm Kuranin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre."* En Nahl: 44. Dhe: *"Është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët."* Et Tevbe: 128

Për shkak të ndjeshmërisë dhe mëshirës së tij ndaj nesh, ai na këshilloi të kemi kujdes nga mashttrimet e shejtanit dhe të mos jemi prej atyre që përmenden në hadithe të shumta, siç thotë i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë)".* Kjo do të thotë të bësh hallall atë që ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, me lejimin më të ulët, duke e justifikuar si blerje, por që realisht është vetëm mbulesë, fshehje dhe borxh përballë shtojcës, e cila është kamatë e qartë. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na këshilloi po me këtë ha-

dith që të kemi kujdes se mos biem në këtë mashttrim duke lejuar atë që ndaloi Allahu sepse është gjëja më e rrezikshme. Ndoshta ndonjë ditë muslimani që bën hallall atë që Allahu e ka bërë haram kthehet e pendohet tek Allahu ngase e di mirë se është duke bërë një haram.

Mirëpo nëse i është zbukuruar duke ia komentuar dhe zbukuruar me komentim apo duke mos pasur njohuri për të, duke menduar se kjo vepër nuk ka ndalesë, atëherë është e pamundur që një ditë të mendojë se duhet të pendohet për të tek Allahu i Madhëruar dhe rreziku i atij që e bën haramin hallall me mendje dhe me bindje është më i rëndë se i atij që e sheh se është haram qartazi. Kush e ha kamatën duke e ditur se është e tillë, edhe pse është në luftë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ashtu siç është përshkruar në ajetin e Kuranit, në fund të fundit për të është më pak e dëmshme sesa ai që e ha kamatën dhe ka bindjen se ajo është hallall. Ky shembull është si rasti i atij që pi alkool dhe ka bindje se është haram, prandaj shpresohet që një ditë do të pendohet, ndërsa situata e atij që pi alkool dhe ka bindje me ndonjë arsye se kjo gjë është hallall është më e rrezikshme se e para pasi ky njeri nuk mendon të pendohet prej saj për sa kohë vazhdon të gabojë në të kuptuar.[2]

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e përmendi këtë shitblerje në këtë hadith si shembull e jo si numër dhe me këtë tregon se çdo mëkat që bën muslimani duke e lejuar të ndaluarën në forma dhe kuptime të ndryshme të saj është rezultat i nënçmimit që Allahu ka lëshuar mbi muslimanët, d.m.th. si rezultat i përhapjes dhe shpërndarjes së të ndaluarës duke e lejuar atë.

Pastaj përmendi edhe llojin e dytë, domethënë gjërat në kundërshtim me sheriatin në të cilat janë përfshirë njerëzit, duke thënë: *"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë) dhe kapeni për bishtat e lopëve (pas pasurisë së kësaj bote)",* pra jeni angazhuar duke vrapuar pas të mirave të kësaj bote, duke kërkuar furnizim, në emër të asaj që Allahu na ka urdhëruar të kërkojmë furnizimin. Muslimanët vrapojnë pas këtij rregulli dhe harrojnë atë që Allahu u ka bërë obligim; mashtrohen pas bujqësisë e blegtorisë dhe harrojnë obligimet. Në hadith u përmend për shembull lufta në rrugën e Allahut.

[2] Kështu është edhe me bidatin, që është më i rrezikshëm sesa mëkati, të cilin njeriu e di se është mëkat.

Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: *"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë) dhe kapeni për bishtat e lopëve (pas pasurisë së kësaj bote), jeni të kënaqur me të dhe e lini xhihadin (luftën), ka për të zbritur Allahu nënçmim mbi ju (dhe nuk e ngre atë) derisa të riktheheni në fenë tuaj."*^[3]

Ky hadith është nga mrekullitë pejgamberike pasi është vërtetuar mbi ne ky nënçmim, siç po e shohim. Ne obligohemi të marrim edhe ilaçin ose shërimin nga ky hadith, duke qenë se e dimë sëmundjen. Ne kemi rendur pas defektit, që na çoi drejt sëmundjes, domethënë nënçmimi, prandaj obligohemi të marrim ilaçin që tregoi Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili na qartësoi se nëse kthehemi tek ai, Allahu do të na e largojë këtë nënçmim.

Njerëzit e lexojnë këtë hadith, e dëgjojnë fjalën e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"derisa të riktheheni në fenë tuaj"* dhe mendojnë se rikthimi në fe është diçka e lehtë, ndërsa unë shoh se rikthimi në fe do punë, duhen përvjelë krahët, ngase të gjithë e dimë se kësaj feje kanë tentuar shumë herë t'ia ndërrojnë realitetin dhe e vërteta është se disa kanë arritur të bëjnë ndryshime, dredhi e lajthitje. Disa prej atyre ndryshimeve dhe shtrembërimeve i dinë të gjithë, ngase janë të njohura për të gjithë, kurse disa të tjera janë më specifike dhe duan studim më të thellë dhe prandaj nuk i dinë shumë muslimanë, të cilët nuk kanë njohuri të bollshme. Disa nga ato çështje janë në këndin e besimit, kurse disa të tjera në këndin e jurisprudencës jofetare, por fatkeqësisht shumë njerëz mendojnë se janë prej fesë. Shembulli i lartshënuar nuk është aspak larg këtij realiteti dhe kjo është edhe sëmundja e parë që ka përmendur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në këtë hadith: *"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë)"*. Kjo lloj tregtie nuk njihet nga shumica e muslimanëve si haram, pasi ende disa dijetarë të vendeve islame-për të cilët shpresojmë të jenë kalaja prej nga buron dhe mbrohet Islami, larg ndikimeve që prekën shumë vende islame- e lejojnë këtë lloj shitblerjeje. Kjo është një dredhi me të cilën lejohet kamata. Ky shembull është njëri nga të shumtët që i dinë ata që merren me jurispru-

dencën islame.

Kjo lloj shitblerjeje duke e ditur se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka ndaluar- ka bërë që muslimanët të jenë në këtë nënçmim dhe është një nga dhjetëra shembujt e argumentimit për atë që përmendëm, prandaj është obligim i yni ta kuptojmë fenë e Allahut rishtazi sipas frymës së Kuranit dhe Sunetit. Kur themi se ka dijetarë që e lejojnë atë për të cilën ka argument të qartë se është e ndaluar, nuk kemi për qëllim të godasim atë dijetar që e ka lejuar, mirëpo duam të këshillojmë muslimanët dhe të bashkëpunojmë me të gjithë, posaçërisht me ata që merren me jurisprudencën islame, që të kuptojmë se ku është shkak i devijimit të disave. Këtë duhet ta bëjmë duke u kthyer te fjala e Allahut si gjykim mes nesh, ngase jemi të urdhëruar kështu, siç e dimë të gjithë ajetin e Kuranit, por të paktë janë ata që po e praktikojnë. Ky ajet është fjala e Allahut: *"Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashitroni atë tek Allahu (te libri i Tij) dhe tek i Dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë."* En Nisa: 59 Ata që kanë studiuar jurisprudencë e dinë se kjo lloj shitblerjeje dhe shumë të tjera janë objekte diskutimi dhe polemikash mes dijetarëve të mëhershëm dhe të mëvonshëm. E, çfarë bëjnë dijetarët bashkëkohorë për këto çështje ku ka polemika dhe mospajtime mes dijetarëve? Me sa kam dije, shumë prej tyre i lexojnë ato polemika e mospajtime dhe i hedhin të gjitha në rrotën e së kaluarës.

Kur jemi në këtë gjendje, atëherë si ka mundësi të rikthehen muslimanët në fenë e tyre, që është edhe ilaçi apo shërimi që ka përmendur Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem? Nëse e marrin dhe kapemi pas tij, do të largohet ky nënçmim, nëse jo, atëherë si mund të përshkruhet ndryshe ky hadith: *"Nëse bëni tregti (merreni me kamatë) dhe kapeni për bishtat e lopëve (pas pasurisë së kësaj bote), jeni të kënaqur me të dhe e lini xhihadin (luftën), ka për të zbritur Allahu nënçmim mbi ju (dhe nuk e ngre atë) derisa të riktheheni në fenë tuaj"*?

Ilaçi i vetëm është të rikthehemi në fenë tonë, në të cilën, siç e dinë të gjithë dhe posaçërisht juristët,

[3] Es Sahiha, 11.

polemika dhe mospajtimi janë të gjera dhe jo si mendojnë disa, se mospajtimet janë vetëm në çështje të pakta degëzore. Mospajtimet arrijnë deri te çështjet e bindjes dhe të besimit, d.m.th. kemi mospajtime të mëdha mes esharive dhe maturidive, gjithashtu mospajtime të mëdha edhe mes mutezilëve, duke mos përmendur grupimet e tjera, e të gjithë llogariten tek ne si muslimanë, ndaj të gjithëve u flet ky hadith: *"...ka për të zbritur Allahu nënçmim mbi ju (dhe nuk e ngre atë) derisa të riktheheni në fenë tuaj"*.

Cila është ajo fe tek e cila duhet të rikthehemi? A është sipas kuptimit dhe drejtimit të filanit, deri në fund të të gjitha medhhebeve, apo ta ngushtojmë rrethin e mospajtimeve te katër shkollat juridike, që janë medhhebe të Ehli Sunetit?

Unë shoh se përmirësimi që duhet të bëjnë dhe tek i cili duhet të bëjnë thirrje thirrësit në Islam apo ata që thërrasin për ngritjen e shtetit islam me sinqeritet është që ta kuptojnë vetë dhe t'i tregojnë edhe umetit se duhet të rikthehen tek ajo që ka sjellë i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem. Rugë tjetër nuk ka dhe mendoj se këtë mendim kanë të gjithë juristët, se nuk ka rrugë tjetër të rikthimit te feja e vërtetë që zbriti Allahu i Madhëruar pos duke studiuar Kuranin dhe Sunetin. E dimë që nga mirësia e imamëve të shquar (Allahu i mëshiroftë), të cilën ua dhuroi Allahu i Madhëruar, është se i këshilluan pasuesit e tyre që të mos i pasonin verbërisht, duke mos i bërë ata thelb të rikthimit, por të riktheheshin në origjinën e fesë, që janë Kurani dhe Suneti.

Nuk është e nevojshme të paraqesim të gjitha fjalët e tyre, por ato të drejtojnë tek ajo që është transmetuar nga të gjithë: *"Nëse hadithi është i vërtetë, atëherë ai është medhhebi im."*

Po mjaftohemi me këtë fjalë të tyre, e cila është argument se të gjithë imamët kanë këshilluar veten dhe umetin, pasuesit e tyre, që të kthehen tek hadithi i vërtetë nëse fjalët e tyre janë në kundërshtim me të.

Kjo hap rrugët edhe nëse është në emër të pasimit-për rikthim te Kurani dhe Suneti.

Do përmendim një shembull aktual që mësohet në të gjitha shkollat islame apo edhe universitetet. Për shembull, falësi gjatë namazit i lëshon duart

poshtë duke mos i lidhur fare. Përse e bën këtë veprë?

Ai thotë se është medhhebi i tij, shkolla e tij juridike.

Për këtë çështje janë munduar dhe kanë hulumtuar të gjithë dijetarët e hadithit, të cilët janë munduar të gjejnë një hadith, qoftë edhe të dobët ose të rrejshëm, se Profeti sal-Allahu alejhi ve sel-lem nuk i ka lidhur duart kur është falur, d.m.th. të djathtën mbi të majtën, kur ka qëndruar në këmbë, por nuk kanë gjetur. Domethënë kjo nuk ekziston fare, por a është kjo nga Islami?

Dikush prej jush mund të thotë se kjo është çështje degëzore, ndoshta mund të jetë liberal e të thotë se kjo është çështje e parëndësishme, ndërsa unë mendoj se çdo gjë me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem është fe, është adhurim. Nuk ka gjëra që nuk kanë vlerë.

Ne kemi bindjen se çdo gjë që ka ardhur nga Profeti sal-Allahu alejhi ve sel-lem është obligim të besohet për fe së pari, duke e peshuar në argumentin e sheriatit: nëse është farz, atëherë mbetet farz, nëse është sunet, atëherë e lëmë sunet, mirëpo ta quajmë "të padobishme apo lëvore ngase është e pëlqyer" nuk është aspak edukatë islame ngase nuk kemi mundësi të mbrojmë brendinë po qe se nuk mbrojmë lëvoren. E them këtë për të polemizuar me fjalorin e tyre.

Ky është një shembull shumë i vogël, që ka të bëjë me namazin. Pse muslimanët të vazhdojnë me këtë veprim kur kemi hadithet e vërteta në çdo libër hadithi, se Profeti sal-Allahu alejhi ve sel-lem i ka kapur duart në namaz gjatë qëndrimit në këmbë. E gjithë kjo nuk është tjetër vetëm se pasim i verbër duke kundërshtuar imamët dhe fjalët e tyre: *"Nëse hadithi është i vërtetë, atëherë ai është medhhebi im."*

Ky shembull i thjeshtë ndoshta nuk u pëlqen disave, prandaj po përmendim një shembull tjetër. Vijon...

Muhamed Nasirudin ALBANI

*Përshtati: Unejs MURATI
Gjilan / Kosovë*



PASTËRTIA E ZEMRËS DHE E GJUHËS

I thashë Ibën Bishrit: “Më trego për veprat e brezave që ishin para nesh!” Ai u përgjigj: “Ata punonin pak, por shpërbleheshin shumë.” I thashë: “Pse ka ngjarë kështu?” Ai u përgjigj: “Sepse kanë pasur zemra të pastra.”

Ndër shenjat më madhore dhe karakteret më fisnike të besimtarëve, të cilat tregojnë plotësinë e besimit dhe fesë së tyre, është pastërtia e zemrave dhe e gjuhëve ndaj vëllezërve të tyre besimtarë. Në zemrat e tyre nuk ka zili, as urrejtje, në gjuhët e tyre nuk ka përgojim, gënjeshtëri e as fyerje. Zemrat e tyre nuk bartin tjetër pos dashurisë, mëshirës, bamirësisë, butësisë dhe bujarisë, kurse gjuhët e tyre flasin vetëm fjalë të dobishme dhe të vërteta. Për të tillët Allahu thotë: *“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”* El Hashr 10

Pra, Allahu i përshkruan besimtarët me dy cilësi madhështore dhe fisnike, njëra prej të cilave ka të bëjë me gjuhën, me të cilën ata shprehin sinqeritetin dhe bëjnë dua për vëllezërit e tyre: *“Thonë: “O Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh...”* Kurse cilësia e dytë ka të bëjë me zemrën, të cilat janë të pastra, nuk kanë zili e

as urrejtje ndaj vëllezërve të tyre.

Pastërtia e zemrës dhe e gjuhës është shenja më e qartë dhe argumenti më i vërtetë që tregon për plotësinë e besimit. Brezat e parë të muslimanëve (selefët) konsideronin se njeriu më i mirë në mesin e tyre ishte ai që e kishte zemrën dhe gjuhën më të pastër. Ijas ibën Muavije thotë: “Tek selefët, më i miri konsiderohej ai që kishte zemrën më të pastër dhe që nuk përgojonte.”

Sufjan ibën Dinari thotë: I thashë Ibën Bishrit: “Më trego për veprat e brezave që ishin para nesh!” Ai u përgjigj: “Ata punonin pak, por shpërbleheshin shumë.” I thashë: “Pse ka ngjarë kështu?” Ai u përgjigj: “Sepse kanë pasur zemra të pastra.”

Shkaku kryesor që i ka bërë të pastra zemrat dhe gjuhët e këtyre njerëzve të zgjedhur është lidhja e fuqishme me Allahun dhe kënaqësia e madhe ndaj Tij. Ibën Kajimi thotë:

“Kënaqësia ndaj Allahut hap derën e pastërtisë së zemrës dhe e bën zemrën të pastër nga mashtrimet dhe të këqijat e tjera. Nuk mund të shpëtojë nga dënimi i Allahut përveç atij që vjen me zemër të pastër. Kurse në anën

tjetër, është e pamundur që zemra të jetë e pastër pa pasur kënaqësi ndaj Allahut; sa më tepër të jetë i kënaqur ndaj Allahut, aq më e pastër do të jetë zemra e tij. Sepse ndryësira dhe mashtrimi janë çift me pakënaqësinë ndaj Allahut, kurse pastërtia e zemrës dhe sinqeriteti i saj janë çift me kënaqësinë ndaj Tij. Edhe zilia është ndër rezultatet e pakënaqësisë, kurse mospasja zili është rezultat i kënaqësisë ndaj Allahut.”

Rezultatet që vijnë nga pastërtia e zemrës nuk mund të numërohen, ajo sjell qetësi në këtë botë, kurse në botën tjetër ka shpërblimin më të mirë. Kur e kanë vizituar Ebu Duxhanen (radij Allahu anhu), i cili ishte i sëmurë, panë se si po i shkëlqente fytyra dhe e pyetën: “Pse të shkëlqen fytyra?” Ai u përgjigj: “Dy vepra kanë qenë ndër më të dashurat për mua: nuk flisja ato fjalë që nuk më ndihmonin dhe zemrën e kam pasur të pastër ndaj muslimanëve.”

Ajo që e ndihmon muslimanin të ketë zemër dhe gjuhë të pastër ndaj vëllezërve të tij është kthimi tek Allahu dhe lutja për sinqeritet, vështrimi i përfundimit të lavdishëm dhe rezultateve të begatshme që vinë nga zemra e pastër, po ashtu vështrimi i përfundimit të keq dhe rezultateve të këqija që vinë nga ai njeri që e ka zemrën të mbushur me zili dhe urrejtje. Janë transmetuar shumë lutje që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i ka bërë duke i kërkuar Allahut që t’i japë udhëzim dhe pastërti të zemrës. Nga Zejd ibën Erkami transmetohet të ketë thënë: “Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thoshte: *“O Allah, jepi devotshmëri shpirtit tim dhe pastroje atë sepse Ti je më i miri që i pastron shpirtat... O Allah, kërkoj të më mbrosh nga dituria e padobishme dhe nga zemra që nuk ka frikë...”*”^[1]

Ndër lutjet madhështore dhe shumë të dobishme që lidhen me pastërtinë e zemrës dhe gjuhës është ajo që transmetohet nga Ebu

Hurejra, i cili thotë:

“Ebu Bekri ka thënë: “O i Dërguar i Allahut, më trego një fjalë që do ta them sa herë që arrin agimi dhe mbrëmja.” Ai tha: *“Thuaj: O Allah, Ti je Njohës i së fshehtës dhe i së dukshmes, Krijues i qiejve dhe i tokës, Zot i çdo gjëje dhe Sundues i saj, dëshmoj se nuk meriton të adhurohet me të drejtë askush pos Teje, kërkoj të më mbrosh nga e keqja e shpirtit tim dhe nga e keqja e shejtanit dhe kurthet e tij.”*”

Kurse në një transmetim tjetër qëndron:

“Kërkoj të më mbrosh që mos t’i bëj keq vetes apo ndonjë muslimani”. Pastaj Pejgamberi alejhi selam tha: *“Thuaje këtë lutje kur të agojë, kur të vijë mbrëmja dhe kur të shkosh të flesh.”*^[2]

Ky hadith madhështor përmban lutje me të cilën i kërkohet Allahut mbrojtje nga e keqja, shkaqet dhe pasojat e saj, sepse e keqja vjen nga shpirti ose nga shejtani dhe për këtë kërkoi që Allahu ta mbrojë me fjalën “kërkoj të më mbrosh nga e keqja e shpirtit tim dhe nga e keqja e shejtanit dhe kurthet e tij”.

Kurse pasoja e së keqes bie mbi atë që e vepron ose mbi vëllanë e tij musliman dhe për këtë kërkoi mbrojtje me fjalën: *“Kërkoj të më mbrosh që mos t’i bëj keq vetes apo ndonjë muslimani”*.

Pra, ky hadith përmban fjalët me të cilat i kërkohet Allahut të na ruajë nga dy burimet e së keqes si dhe nga pasojat e saj.

Për Allahun! Sa lutje e plotë që është kjo, sa qëllim të bukur që ka, sa bukur është që muslimani ta praktikojë këtë në lutjet e tij të mëngjesit dhe të mbrëmjes, siç udhëzoi Pejgamberi i ndershëm sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

“El Fevaïd el Ment’hure”
Dr. AbduRrezak EL BEDER

Përshtati: Jeton BOZHLANI
Vushtrri / Kosovë

[1] Transmeton Muslimi (2722).

[2] Transmeton Tirmidhiu (3392), Ebu Davudi (5067).



KUSH ËSHTË FITUARI?

Nuk ka situatë më të mirë e më të këndshme sesa kur Allahu i Madhëruar të mbron, të shpëton nga zjarri i xhehennemit dhe ti e kalon Urën e Siratit dhe hyn në xhennet duke fituar këtë dhunti të madhe.

Në disa kuvende flitet për fitimin, kush janë të fituarit dhe cilat janë shkaqet e fitimit. Kjo fjalë përsëritet shpesh dhe mendja kufizohet nga fitimi, nga kënaqësit e përkohshme dhe çështje kalimtare. Disa flasin për fitimin në tregti, disa në lojëra sportive, disa në kryerjen e gjërave të ndaluara si kumari. Pra, bisedat për fitimin janë të ndryshme, ashtu siç është edhe forma, e vërteta, fusha, shkaqet e tij, por shumica harrojnë fitimin e madh në takimin me Zotin e Botëve, fitimin me kënaqësinë e Tij, fitimin nga shpëtimi prej dënimit të Tij, fitimi me xhennetin e Tij. Ky kuptim mungon shumë nga mendja e njerëzve sepse janë preokupuar me kënaqësinë, të mirat dhe epshet e dunjasë. Allahu az-ze ve xhel-le thotë: ***"Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë.***

Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin! "El-Ankebut 64 Është obligim për çdo musliman që përherë të ketë parasysh fitimin e madh, fitimin e qartë ditën kur do të takojmë Allahun az-ze ve xhel-le.

O besimtarë, le të ndalemi e të meditojmë për këtë pikë, për këtë fitim të madh dhe për të vërtetën e tij. Allahu i Madhëruar thotë: ***"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet***

do t'u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i xhehennemit dhe hyn në xhennet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese." Alu Imran 185

Këtu është vendi i fituesve, të cilëve Allahu az-ze ve xhel-le u dhuroi të mira me fitim të vërtetë dhe të madh. Fitimi është shpëtim për frikacakun dhe arritje për dëshiruesin, këto dy bashkohen te besimtarët, banorët e xhennetit i shpëton Allahu az-ze ve xhel-le nga zjarri i xhehennemit dhe i dhuron xhennetin. Kjo është e vërteta e fitimit, a ka frikë më të madhe se zjarri? A ka gëzim më të madh se xhenneti? Është obligim për çdonjërin nga ne që ta kujtojmë këtë vend të madh sepse të gjithë ne jemi duke shkuar drejt atij. Është transmetuar në Sahihul Muslim nga hadithi i Ebu Seid el-Hudrij radijallahu anhu, se vërtet Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: ***"Do të vendoset ura mbi xhehennem e do të lejohet ndërmjetësimi im dhe thonë: -O Allah, na shpëto!" E pyetën: "O i Dërguari i Allahut, ç'është ura?" Tha: "Mbi urë do të ketë ganxha të mëdha, si gjembat e sadanit, disa e kalojnë sa çel e mbyll sytë, dikush si vetëtima, dikush si era, dikush si kali***

i shpejtë, dikush si shaluesit e devesë, dikush duke vrapuar, dikush duke ecur, dikush duke u zvarritur, e dikush rrëmbehet dhe hidhet në xhehennem."

Njerëzit mbi këtë urë janë tre llojesh, siç i ka caktuar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Imagjino kalimin e njerëzve duke kaluar këtë urë të ndërtuar mbi xhehennem, imagjino veten tënde duke qëndruar mbi këtë urë, e cila, siç është përmendur në disa hadithe, është më e hollë se fija e flokut. Ti ke vendosur këmbën tënde dhe para e pas vetes ke njerëz të tjerë, që e kalojnë urën me shpejtësi të ndryshme: disa do ta kalojnë si vetëtimja, disa si era e disa si vrapimi i kalit, në bazë të respektimit të urdhrave të Allahut az-ze ve xhel-el në këtë botë. Shiko gjendjen tënde tani dhe imagjino veten së bashku me ata duke ecur në atë vend. Allahu i Lartësuar thotë: *"Ata kanë marrë zotën, në vend të Allahut, për t'i pasur ndihmës. Por jo, ata do ta mohojnë adhurimin e tyre dhe do të bëhen armiq të tyre."* Merjem 81-82. A je ti nga të shpëtuarit, të fituarit?

O besimtarë, mund të pyesni se cilat janë karakteristikat e të fituarve dhe cilat janë veprat me anë të të cilave e arritën këtë fitore të madhe? Përgjigjen e gjeni në librin e Allahut të Madhëruar, në një ajet ku ka tubuar të gjitha shkaqet e fitimit dhe të dobisë. Thotë i Lartësuar: *"Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë."* Nëse rob i Allahut ka këto katër cilësi, do të jetë nga të fituarit:

- 1-Bindje në Allahun az-ze ve xhel-le.
- 2-Bindje në të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.
- 3-Frikë ndaj Allahut dhe qëndrimit para Tij.
- 4-Devotshmëri.

Kush cilësohet me këto tipare dhe është në këtë gjendje, do të jetë nga të fituarit. Pastaj kujto gjendjen e besimtarëve të fituar, se çfarë kanë fituar pas shpëtimit nga zjarri i xhehennemit dhe ruajtja nga hyrja në të.

Kujto çfarë ka përgatitur Allahu az-ze ve xhel-le për të fituarit? Allahu i Lartësuar thotë: *"Vërtet, për punëdrejtët është përgatitur e mira (xhenneti), kopshte dhe vreshta, vajza të reja, të së njëjtës moshë dhe kupa të plota. Atje nuk do të dëgjojnë biseda e as gënjeshttra. Kështu është shpërblimi nga Zoti yt- dhuratë sipas meritës."* En-Nebe 31-36

Nuk ka situatë më të mirë e më të këndshme sesa kur Allahu i Madhëruar të mbron, të shpëton nga zjarri i xhehennemit dhe ti e kalon Urën e Siratit dhe hyn në xhennet duke fituar këtë dhunti të madhe. Mendo për këtë vend, kur banorët e xhennetit hyjnë në të nga dera e të fituarve. I Madhëruari thotë: *"Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtarët, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t'u thuhet): "Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e xhennetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe."* El-Hadid 12. Gjithashtu i Lartësuar thotë: *"Kurse për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të ketë kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Kjo është fitorja madhështore."* El-Buruxh 11. A është dikush që kërkon ndonjë fitore më të madhe se kjo? Ky është qëllimi final dhe përfundimi i përfundimeve, me të cilin ata fituan kënaqësinë e Zotit të Tokës dhe qiellit, u gëzuan me afrimin tek Ai dhe kënaqësitë e Tij, me dhuntinë e shikimit në Fytyrën e Tij. Kjo është dhuntia më e madhe dhe kënaqësia më e madhe.

Lus Allahun az-ze ve xhel-le me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta që të na bëjë nga të fituarit dhe të shpëtuarit, të na japë sukses në bindjen ndaj urdhrave të Tij në mënyrë që të arrijmë kënaqësinë e Tij dhe që të na udhëzojë në rrugë të drejtë! Ai me të vërtetë e dëgjon duanë.

Dr. AbduRrezak EL BEDER

*Përshtati: Fehmi DALIPI
Gjilan / Kosovë*



SIGURIA DHE VLERA E SAJ NË ISLAM

Duke u nisur nga kjo, ne i kundërshtojmë të gjitha shpërthimet që ndodhin sot në vendet muslimane dhe jomuslimane sepse këto shpërthime kanë për qëllim qytetarët e rëndomtë, të cilët janë të sigurt.

Siguria dhe rehatia janë ndër mirësitë më të çmuara që na janë dhënë nga Allahu i Madhërishtëm. Allahu këtë mirësi ia dha fisit Kurejsh, siç e ka përmendur në shumë ajete kur'anore, ku thotë:

"Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt (Mekën), ndërkohë që njerëzit rreth tij po grabiten? A mos vallë ata besojnë në gjëra të kota, ndërsa dhuntitë e Allahut i mohojnë?!" El-Ankebut 67

Gjithashtu Allahu i Madhërishtëm thotë: "Ata thonë: *"Nëse ndjekim udhëzimin së bashku me ty, së shpejti do të jemi të dëbuar nga vendlindja". Vallë, a nuk ua kemi mundësuar, që të jetojnë në një vend të shenjtë e të sigurt, ku sillen fruta të llojllojshme, si ushqim prej Nesh? Por shumica e tyre nuk e dinë."* El-Kasas 57

Pra, siguria dhe rehatia janë nga dhuntitë më të mëdha të Allahut ndaj robërve. Në këtë dhunti njeriu e gjen veten të sigurt dhe kryen obligimin e tij në profesionin ku punon, shkon e vjen i sigurt dhe i qetë. Kur Allahu ua dhuroi këtë mirësi Kurejshëve, i urdhëroi

që ta adhurojnë vetëm Atë si falënderim. Për këtë Allahu thotë në Kur'an:

"(Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh. Për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike." El-Kurejsh

Kur Kurejshët e përgënjeshtroan të Dërguarin e tyre, e kundërshtuan Allahun dhe nuk e falënderuan për dhuntinë që ua kishte dhënë, Allahu sigurinë ua ktheu në frikë e pasiguri, ngopjen e tyre në uri, siç thotë Allahu i Madhërishtëm: *"Allahu e ka bërë shembull qytetin (e Mekës), i cili ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i arrinin ushqime të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banorët e tij i mohuan dhuntitë e Allahut dhe Ai i bëri të shijojnë urinë dhe frikën, si ndëshkim për atë që bënë. Vërtet, atyre u erdhi një i Dërguar nga radhët e tyre, por ata e quajtën për gënjeshtar dhe i goditi dënimi, ngaqë ishin të padrejtë."* En-Nahl: 112-113. Ndërsa kur besimtarët e realizuan të drejtën e Allahut, duke e veçuar Atë në adhurim, Allahu ua zëvendësoi frikën

me siguri, qetësi e rehati dhe realizoi prem-timin që u kishte dhënë në fjalën e Tij:

"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që pas kësaj mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët." En-Nur 55

Allahu ua përkujtoi atyre dhuntinë e sigurisë që u kishte dhuruar. Allahu thotë:

"Dhe kujtohuni kur ishit pak në numër, ishit të dobët në tokë e kishit frikë se njerëzit (mosbesimtarët) do t'ju gllabëronin! Ai ju strehoi dhe ju forcoi me ndihmën e Tij e ju dha shumë të mira, që ju ta falënderoni." El-Enfal 26

Allahu i ka urdhëruar besimtarët që ta ruajnë dhuntinë e sigurisë, të rehatisë e qetësisë, duke i dalë përballë çdokujt që dëshiron ta rrezikojë sigurinë e tyre apo të krijojë kaos në mesin e tyre, qofshin këta muslimanë apo jomuslimanë, individë apo grupe. Allahu thotë:

"Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe që bëjnë shkatërrime në tokë është të vriten ose të gozhdohen, ose t'u këputen duart dhe këmbët tërthorazi, ose të dëbohen nga vendi. Ky ndëshkim është poshtërim për ata në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër për ata do të ketë dënim shumë të madh." El-Maide 33

Ky ajet quhet ajeti i -el-hirabe- luftimit. Lufta është e kundërta e paqes, e cila është shpëtim nga çdo e keqe dhe e dëmshme dhe siguri i shpirtit dhe i pasurisë.

Disa juristë të fesë, el-hirabe e kanë përkufizuar kështu: Dalja e një grupi të armatosur në vendin islam për të shkaktuar kaos, për derdhjen e gjakut, marrjen e pasurisë, çnderimin e njerëzve, shkatërrimin e të mbjellave, duke kërcënuar kështu fenë, moralin, rendin

dhe ligjin. Nuk ka dallim që ky grup të jetë nga muslimanët apo jomuslimanët përderisa i shkaktojnë këto trazira në vendin islam dhe përderisa e bëjnë këtë ndaj atyre që gjakun e kanë të mbrojtur.

Nëse këto krime i kryen edhe vetëm një person, ai konsiderohet njeri që duhet të luftohet. Kjo dukuri ndryshe quhet edhe "bllokim i rrugës apo plaçkitje" sepse kur ndodh kjo, njerëzit u shmangen rrugëve nga frika se mos vriten, se mos u merret pasuria apo se mos çnderohen.

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është distancuar nga ai që mban armë dhe del në rrugë duke frikësuar njerëzit e sigurt. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

"Kush na drejton armët nuk është prej nesh."^[1] Ky njeri nëse nuk e ka pasur nderin në këtë botë që të cilësohet si musliman, nuk do ta ketë këtë nder as pas vdekjes sepse secili ringjallet në atë që ka vdekur. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Kush del nga respektimi (i ligjit) duke u larguar nga xhemati (bashkësia) e pastaj vdes, ai do të vdesë me vdekje të injorancës."*^[2]

Me të vërtetë Allahu e ka nderuar njeriun, e ka krijuar me Dorën e Tij, i ka dhuruar shpirtin, i ka urdhëruar melaiket që t'i bien në sexhde (formë nderimi), ia ka nënshtuar çfarë ka në qiej e në tokë, i ka dhënë fuqi e dhunti në mënyrë që ta udhëheqë tokën dhe të arrijë në piedestalet më të larta të mundshme si nga ana materiale ashtu edhe ajo shpirtërore. Mirëpo njeriu nuk mund t'i realizojë qëllimet e veta dhe ta arrijë kulmin përveç nëse i ofrohen të gjitha kushtet e ngritjes dhe nëse merr të gjitha të drejtat që i takojnë. E drejta e tij themelore që Islami ia ka garantuar është e drejta e jetës. Kjo është e drejtë e shenjtë dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet të keqpërdoret shenjtëria e saj.

Allahu thotë: *"Mos e mbytni njeriun që Allahu e ka ndaluar (mbytnjen e tij) përpos kur është*

[1] Mutefekun alejhi

[2] Muslimi

me vend (ligj)." El-En'am 151

Gjithashtu thotë: *"Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtet, vrasja e tyre është gjynah i madh."* El-Isra 31

Kjo ndalesë është e vërtetuar në të gjitha ligjet e mëparshme. Allahu e ka bërë të ligjshëm kisasin^[3] edhe për ata që ishin para nesh si ndalim dhe frikësim për derdhjen e gjakut dhe vrasjen e njerëzve pa të drejtë. Allahu i Madhërishtëm thotë: *"Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrasë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrasë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve. Të Dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në tokë."* El-Maide 32. Na ka urdhëruar me atë që i kishte urdhëruar edhe ata që ishin para nesh. Allahu thotë: *"O besimtarë! Është caktuar për ju kisasi për vrasje: i liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën. Ai (vrasës) që falet nga farefisi i të vrasurit, duhet të sillet njerëzishëm dhe le të zbatojë dëmshpërblimin më të mirë. Kjo (falje) është një lehtësi dhe mëshirë nga ana e Zotit. E kushdo që pas kësaj (faljes), e kapërcen kufirin, do të marrë një dënim të dhimbshëm."* El-Bekare 178

Në Islam nuk është i çmuar vetëm shpirti i muslimanit, por i muslimanit dhe jomuslimanit në mënyrë të barabartë. Nuk vritet muslimani vetëm me diçka që e obligon vrasjen e tij, d.m.th. siç e ka përmendur Allahu në shumë ajete fjalën "vetëm me të drejtë". Gjithashtu nuk vritet jomuslimani vetëm se me atë që e obligon vrasjen e tij. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka konsideruar shumë të rëndë vrasjen e padrejtë të jomusli-

manit që jeton në paqe me muslimanët. Për këtë ka thënë: *"Kush vret atë të cilit i është dhënë besa (jomusliman), ai nuk do ta nuhasë erën e xhennetit, edhe pse era e tij nuhatet nga dyzet vjet larg."*^[4]

Ndërsa për atë që vret një besimtar pa të drejtë Allahu ka thënë:

"Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh." En-Nisa 93

Hadithe të shumta kanë ardhur që tregojnë për madhërimin e të drejtave të muslimanit, ruajtjen e gjakut të tyre dhe qartësimin e dënimit mbi ata që e bëjnë të kundërtën. Ebu Bekrete radijallahu anhu thotë se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj është i ndaluar për ju, ashtu siç është e ndaluar kjo ditë e juaja, në këtë vend tuajin, në këtë muaj të ndaluar. Allahun do ta takoni dhe Ai do t'ju pyesë për veprat tuaja, mos u zmbarsni pas meje si femohues ose të humbur, që ta vrisni njëri-tjetrin."*^[5]

Nafiu tregon se Ibën Umeri një ditë e shikoi Qaben dhe tha: "Sa e çmuar që je dhe sa e shenjtë që je, por besimtari është më i shenjtë tek Allahu sesa ti."^[6]

Ebu Hurejra radijallahu anhu tregon se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Largohuni nga shtatë gjërat shkatërruese."* I thanë: *"Cilat janë ato o i Dërguari I Allahut?"* Tha: *"Bërja shok Allahut, magjia, vrasja e shpirtit që e ka ndaluar Allahu, pos me të drejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, ikja nga fronti i luftës, shpifja ndaj grave të ndershme besimtare e të gjora."*^[7]

Ibën Umeri radijallahu anhu thotë: "Ka thënë i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

[3] Kisasi në të drejtën juridike islame është ligji i barazisë në ndëshkim (Përkthim i Kur'anit nga Ef, Hasan Nahi).

[4] Buhariu

[5] Mutefekun alejhi

[6] Tirmidhiu

[7] Mutefekun alejhi

[8] Buhariu

"Besimtari vazhdon të ketë hapësirë në fenë e tij përderisa nuk derdh gjakun e ndaluar."^[8]

Bera' ibën Azibi radijallahu anhu thotë se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Shkatërrimi i botës është më i lehtë tek Allahu sesa të vritet një besimtar pa të drejtë."*^[9]

Ebu Seid el-Hudriu thotë se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sikur banorët e qiellit dhe të tokës të binin në ujdi që ta vrisnin një besimtar, Allahu do t'i fuste në zjarr që të gjithë."*^[10]

Për shkak të rëndësisë dhe shenjtërisë së gjakut, gjëja e parë që Allahu do të gjykojë mes robërve është gjykimi në gjakra, siç tregojnë për këtë hadithi: *"Çështja e parë që do të gjykohet mes robërve Ditën e Gjykimit është çështja e gjakrave."*^[11]

Këto ishin disa hadithe që tregojnë për dënimin e vrasës të vret dikë tjetër, por cili është dënimi i atij që vret veten? Vetëvrasja është mëkat i madh dhe dënimi për të është i hidhur. Në hadithin që e transmeton Ebu Hurejra, i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Ai që e vret veten me hekur, atë hekur do ta ketë në dorë duke e futur në barkun e tij në zjarrin e xhehennemit duke qëndruar ashtu përgjithmonë. Ai që e vret veten me helm, helmën do ta ketë në dorë duke e marrë atë në zjarrin e xhehennemit përgjithmonë. Ai që e hedh veten nga një vend i lartë dhe vritet, ai do të hidhet ashtu në zjarrin e xhehennemit përgjithmonë."*^[12]

Ky ishte dënimi i atij që vetëvritet. Si qëndron puna nëse ai vetëvritet duke hedhur veten në erë dhe shkakton vrasjen e të tjerëve, muslimanë ose jo? Ky vetëvrasës ka kryer tre krime: ka vranë veten, ka vranë muslimanin dhe jomuslimanin, gjaku i të cilit është i mbrojtur, prandaj i meriton të gjitha

dënimet që u përmendën më herët. Nëse shpërthimi i tij sjell vrasjen e më shumë njerëzve, atëherë për çdo shpirt do të ketë dënim të veçantë.

Nga madhëria e Islamit dhe lehtësia e tij është se edhe gjatë kohës së luftës e ka kufizuar luftën vetëm mes ushtarëve dhe e ka ndaluar rreptësisht që lufta të tejkalojë nga mejdani i saj te njerëzit që janë të sigurt e të qetë nëpër faltoret e tyre, nëpër shtëpitë dhe tregjet e tyre. Ibën Umeri radijallahu an-huma thotë: *"Kalo i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pranë një gruaje të vranë gjatë çlirimit të Mekës, pastaj tha: "Kjo nuk do të luftonte (kundër nesh)", pastaj ndaloi nga vrasja e grave dhe fëmijëve."*^[13]

Në bazë të këtij arsytimi (ajo nuk do të luftonte), dijetarët kanë thënë se iu bashkëngjitën këtij rregulli gratë, fëmijët, shërbyesit e faltoreve, haxhilerët, pleqtë, të sëmurët dhe të tjerë të cilët janë distancuar nga lufta, që ndryshe quhen qytetarë, prandaj duhen respektuar ata dhe pasuria e tyre. Duke u nisur nga kjo, ne i kundërshtojmë të gjitha shpërthimet që ndodhin sot në vendet muslimane dhe jomuslimane sepse këto shpërthime kanë për qëllim qytetarët e rëndomtë, të cilët janë të sigurt.

Islami, siç e thamë, e ndalon në mënyrë të prerë vrasjen e qytetarëve në gjendje lufte, kështu që kuptohet si qëndron çështja në situata sigurie dhe paqeje.

Marrë nga revista "Tevhid", 107
Dr. Abdul Adhim BEDEVIJ

Përshtati me disa ndryshime:
Mr. Fidan XHELILI
Aman/Jordani


[9] Tirmidhiu, e ka saktësuar Albani

[10] Tirmidhiu, e ka saktësuar Albani

[11] Mutefekun alejhi

[12] Mutefekun alejhi

[13] Mutefekun alejhi



EKSTREMIZMI

ASHTU SIÇ ËSHTË NË TEPRIM ËSHTË
EDHE NË LËSHIM

Të gjitha llojet e ekstremizmit janë të ndaluara dhe mund të të nxjerrin nga feja dhe të të çojnë në humbje, siç u ka ndodhur gjeneratave para nesh. Askush nga ne që i ka dhënë Allahu dije në fenë e tij, mendjemprehtësi në dispozita dhe i vendos çështjet në vendin e tyre nuk dyshon në të.

Falënderimi i takon vetëm Allahut. Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Janë të shumta fushatat kundër ekstremizmit në fe dhe janë me vend sepse ekstremizmi në fe është i ndaluar me Kur'an, Sunnet dhe konsensusin (ixh-main) e dijetarëve. Allahu i Lartësuar thotë: *"O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë."* En-Nisa 171
Ndërsa në ajetin tjetër thotë: *"Thuaju: O*

ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë së vërtetës." El-Maide 77. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kujdes nga ekstremizmi sepse me të vërtetë ajo që i ka shkatërruar gjeneratat para jush është ekstremizmi."* Ekstremizmi në fe është tejkalimi i kufijve në raport me atë që është e lejuar, nganjëherë edhe në adhurim, siç është rasti i tre personave: njëri tha se do të falet dhe nuk do të flejë, i dyti tha se do të agjërojë dhe nuk do të hajë, kurse i treti tha se nuk do të martohet kurrë. Nganjëherë ekstremizmi është edhe në dispozita, kur një vepër që është e prefer-

uar (e pëlqyer) e ngre dhe e bën vaxhib (obligim). Është ekstremizëm që të gjykosh për mëkatin e madh, i cili është nën kufrin dhe shirkun, duke e nxjerrë dikë nga feja. Nganjëherë ekstremizëm është edhe në urdhrin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja, siç është ekstremizmi i mu'tezilive, të cilët kanë lejuar kryengritjen ndaj udhëheqësit duke e argumentuar se është urdhër për të mirë dhe ndalim nga e keqja apo ekstremizmi në haram dhe hallall, kur lejon të ndaluarën dhe ndalon të lejuarën.

Të gjitha llojet e ekstremizmit janë të ndaluara dhe mund të të nxjerrin nga feja dhe të të çojnë në humbje, siç u ka ndodhur gjeneratave para nesh. Askush nga ne që i ka dhënë Allahu dije në fenë e tij, mendjemprehtësi në dispozita dhe i vendos çështjet në vendin e tyre nuk dyshon në të.

Mirëpo ekzistojnë njerëz që janë në të kundërtën e ekstremit të teprimit në fe-ata bëjnë lëshime dhe tolerancë në fe. Nuk ka dyshim se feja jonë është fe e tolerancës, mirëkuptimit dhe mesatares, mirëpo duhet që kjo tolerancë të jetë në dispozitat e Allahut, duke i marrë lehtësimet sipas nevojës, pasi feja në çdo aspekt nuk ka rëndime dhe vështirësi. Allahu thotë: *"Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij."* El-Bekare 286

"...dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi." El-Haxh 78

Dhe: *"Allahu nuk dëshiron t'ju sjellë ndonjë vështirësi."* El-Maide 6

Mirëpo ekstremizmi në tolerancë, dalja nga dispozitat e Allahut, nuk quhet tolerancë por vështirësi, anulim i dashurisë për hir të Allahut (elvela) dhe urrejtjes

për hir të Allahut (el berae) në Islam.

Barazimi mes muslimanit dhe jobesimtarit me anë të tolerancës apo anulimi i gjërave që e nxjerrin njeriun nga feja (nevakidul islam), barazimi mes feve, si për shembull barazimi mes Islamit, Judaizmit dhe Krishterimit dhe feve idhujtare janë shembuj që kanë të bëjnë me ekstremizmin në tolerancë dhe lëshime. Ne duhet ta refuzojmë dhe urrejmë ashtu siç urrejmë ekstremizmin në teprim, pasi nganjëherë ekstremizmi në tolerancë dhe lëshim mund të jetë më i rrezikshëm se ekstremizmi i teprimit në fe sepse ekstremizmi në tolerancë dhe lëshime e bën fenë e mohuesit (qafirrit) të barabartë me fenë e vërtetë dhe kjo është kufër, sipas të gjithë dijetarëve (ixhma), kurse ekstremizmin në teprim shumica e dijetarëve e shohin si humbje (dalal). Dijetarët kanë thënë se prej gjërave që e nxjerrin njeriun nga feja (nevakidul islam) është kur nuk e bën jobesimtarin (qafirin) jobesimtar apo kur dyshon në kufrin (mohimin) e tij. Ata që kanë rrëshqitur në këtë rrëshqitje të rrezikshme duhet të shikojnë çështjen e tyre dhe të kthehen tek e vërteta sepse kthimi tek e vërteta (hakk) është fisnikëri. Kthimi tek e vërteta është më i mirë se vazhdimi në të shtrembëtën (batil).

Allahu na e mundësoftë që të përfitojmë dituri të vlefshme dhe të veprojmë punë të mira dhe paqja e Allahut qoftë mbi të Dërguarin tonë, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij!

Dr. Salih ibën Fevzan El FEVZAN

*Përshtati: Eshrefedin ISMAJLI
Viti / Kosovë*



RËNDËSIA E AMANETIT

DHE NXITJA PËR RUAJTJEN E TIJ

Robër të Allahut! Amaneti është një gjë madhështore, që ka një pozitë të lartë në fe, prandaj është obligim që t'i kushtohet një kujdes i shtuar. Shumë ajete në Kur'an dhe shumë hadithe të Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem e vlerësojnë lart atë dhe tregojnë se kush kujdeset që ta ruajë amanetin ka shpërblim në këtë botë dhe në tjetrën, kurse ai që nuk e përfill dhe nuk kujdeset për të, do të ketë dënim në të dyja botët.

Lavdërimi dhe falënderimi i takon Allahut, prandaj Atë e lavdëroj. Dëshmoj se nuk meriton të adhurohet me të drejtë askush pos Allahut të vetëm, i Cili nuk ka ortak, Krijuesi i të gjitha krijesave. Dëshmoj se Muhamedi sal-Allahu alejhi ve sel-lem është rob i Allahut, i Dërguar dhe i zgjedhur i Tij.

O ju besimtarë! Kini drojë Allahun sepse ai që ka drojë Allahun, Ai do ta ruajë dhe do ta udhëzojë drejt së mirës së kësaj bote dhe tjetrës. Droja nga Allahu është krenari në këtë botë dhe tjetrën dhe se përfundimi i mirë gjithmonë do të jetë për ata që kanë drojë Allahun.

Pastaj duhet ta dini se amaneti është një përgjegjësi e madhe dhe një obligim madhështor që njeriu e ka marrë mbi vete në këtë botë. Njeriut i është besuar amaneti

sepse pasi e krijoi Allahu, ia ofroi amanetin dhe ky e pranoi dhe i mori përsipër përgjegjësitë dhe pasojat e tij në këtë botë.

Robër të Allahut! Amaneti është një gjë madhështore, që ka një pozitë të lartë në fe, prandaj është obligim që t'i kushtohet një kujdes i shtuar. Shumë ajete në Kur'an dhe shumë hadithe të Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem e vlerësojnë lart atë dhe tregojnë se kush kujdeset që ta ruajë amanetin ka shpërblim në këtë botë dhe në tjetrën, kurse ai që nuk e përfill dhe nuk kujdeset për të, do të ketë dënim në të dyja botët. Allahu thotë: ***“Dhe nëse njëri prej jush ka besim tek tjetri, atëherë le ta kthejë atë që i është besuar dhe le t'i frikësohet Allahut.”*** El Bekare 283

Ai thotë: *“Ne ua ofruam amanetin (kryerjen e obligimeve) qiejve, tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).”* El Ahzab 72

“Allahu ju urdhëron që amanetet t’ua ktheni atyre që u përkasin.” En Nisa 58

Allahu përmend se ruajtja e amanetit është cilësi e besimtarëve të plotë: *“...të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra.”* El Mu’minun 7

Pastaj thotë: *“...ata do ta trashëgojnë Firdesin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.”* El Mu’minun: 11. Pra, ai që e kryen amanetin dhe i kushton rëndësi, do të ketë përfundim të lavdishëm.

Ndërsa humbjen e amanetit, Allahu e përmend tek cilësitë e çifutëve.

“Por ka edhe të atillë (ehlul kitab), që nëse u jep në besim, qoftë edhe një dinar, nuk ta kthejnë.” Alu Imran 75

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem përmend se mosruajtja e amanetit është cilësi edhe e munafikëve. *“Shenjat e munafikut janë tri: kur flet gënjen, kur premtton nuk e kryen atë, dhe kur i besohet diçka tradhton.”* Gjithashtu ai përmend se amaneti është nga imani: *“Ai që s’ka amanet s’ka as iman.”*

Ky hadith na tregon për rëndësinë e amanetit, i cili qenka nga imani. Sa më tepër amanet ka besimtari dhe e ruan atë, aq më tepër do të shtohet imani i tij, por aq sa i mungon besa dhe amaneti aq i mungon edhe imani.

Robër të Allahut! Ndër ajetet madhështore të Kur’anit, që e sqarojnë rëndësinë dhe pozitën e amanetit, është fjala e Allahut:

“Ne ua ofruam amanetin (kryerjen e obligimeve) qiejve, tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).” El Ahzab: 72

Vështroje këtë ajet fisnik! Përmes këtij ajeti do ta mësosh rëndësinë e amanetit, sepse me këtë ajet Allahu na njofton se amanetin ua ka ofruar qiejve, tokës dhe kodrave, ua ka ofruar që të zgjedhin, por ato nuk pranuan, jo për t’i bërë mëkat Allahut, e as për t’u larguar nga shpërblimi i Tij, por për shkak të frikës nga rëndësia e madhe që ka përgjegjësia. Për këtë Allahu tha: *“...dhe u frikësuan ta pranojnë atë”*. Kodrat u frikësuan që ta bartin amanetin, u frikësuan qiejt edhe toka, ndërsa njeriu e pranoi atë, sepse *“u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur”*. Edhe pse u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur, ai e pranoi amanetin me të gjitha pasojat e tij, kurse pasojat e tij janë shpërblimi i Allahut në këtë botë dhe në tjetrën për atë që e ruan amanetin dhe ndëshkimi i Tij për atë që e humb amanetin. Njeriu e pranoi bartjen e amanetit, e pranoi këtë përgjegjësi të madhe me gjithë padrejtësinë dhe paditurinë e tij dhe për këtë ai jeton gjithë jetën e tij duke bartur përgjegjësinë e amanetit, ndërsa Allahu do ta pyesë për të në ditën kur do të takohet me Të.

Nëse vështrojmë gjendjen e njerëzve, nëse vështrojmë bartjen e amanetit dhe se si janë duke e kryer njerëzit atë, do të vërejmë se ata ndahen në tre grupe:

Grupi i parë e ka bartur amanetin sipërfaqësisht, ndërsa në brendinë e tyre nuk e kanë bartur atë. Këta janë munafikët, të cilët shfaqin atë që nuk e kanë në zemër: kur vijnë tek besimtarët shfaqin imanin dhe besën, duke u frikësuar prej tyre, ndërsa kur janë në shoqërinë e jobesimtarëve shfaqin kufrin (mosbesimin). Munafikët shfaqin imanin dhe fshehin kufrin dhe në shikim të jashtëm duken se e bartin amanetin, por në zemrat e tyre janë tradhtarë, janë tradhtarë të vetvetes sepse mendojnë se janë duke tradhtuar Allahun dhe besimtarët, por në realitet tradhtojnë veten e tyre duke shkuar drejt shkatërrimit të sigurt në këtë botë dhe në tjetrën.

Grupi i dytë janë ata të cilët nuk e kanë bartur amanetin as nga ana e jashtme e as me zemrat e tyre. Këta janë jobesimtarët sepse këta si për nga ana e jashtme ashtu edhe nga brendia e tyre janë të njëjtë në mosbesim dhe largim nga feja e Allahut. Grupi i tretë janë besimtarët, të cilët e kanë bartur amanetin dhe janë përpjekur ta realizojnë atë. Këta janë njerëzit e imanit dhe njerëzit që i ka nderuar Allahu në këtë botë dhe në tjetrën. Kur Allahu përmendi ajetin paraprak, ku thuhet se qiejt, toka dhe kodrat u frikësuan ta pranojnë amanetin, por e pranoi njeriu, menjëherë pas këtij ajeti Ai përmend grupet e njerëzve që ndahen lidhur me amanetin: ***“Si pasojë, Allahu do t’i dënojë munafikët dhe munafiket, idhujtarët dhe idhujtare, ndërsa do t’ua pranojë pendimin besimtarëve dhe besimtareve. Vërtet Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”*** El Ahzab 83

Në raport me ruajtjen e amanetit, Allahu ka përmendur se njerëzit ndahen në tre grupe: dy grupe do të dënohen -munafikët dhe idhujtarët-, ndërsa grupi i tretë do të shpërblehet, e këta janë njerëzit e imanit.

Allahu na bëftë prej tyre!

Robër të Allahut! Nëse dëshirojmë që ta vështrojmë amanetin nga aspekti se me kë lidhet, kujt i obligohet dhe cilat janë sferat që përfshihen në të, atëherë le t’i shqyrtojmë disa herë fjalët e Allahut në vijim:

“O besimtarë! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin e mos i tradhtoni amanetet me vetëdije.” El Enfal 27

Ky ajet tregon qartë se amaneti ndahet në tre lloje, nga aspekti se me kë lidhet:

1. Amaneti që lidhet me detyrimet e robërve ndaj Allahut, sepse Allahu t’i ka lënë në amanet obligimet e Tij në këtë botë. Ai të ka krijuar që t’i bësh ibadet, të ka urdhëruar për disa gjëra dhe të ka ndaluar nga disa të tjera dhe nuk të ka lënë në papërgjegjshmëri. Të ka krijuar vetëm për një qëllim të lavdishëm, që është të adhuroarit e Allahut, dhe kjo të është lënë në amanet, madje amaneti më madhështor është kryerja e ibadetit ndaj Allahut. Kjo është arsyeja që teuhidi është amanet, ndërsa shirku është tradhti. Amaneti më madhështor është teuhidi, kurse tradhtia më e madhe është shirku. Kush e adhuron Allahun me sinqeritet, i kryen urdhrat, largohet nga ndalesat dhe bëhet i kujdesshëm nga shirku, me të vërtetë se ka kryer amanetin ndaj Allahut. Nëse ti e njeh Allahun nëpërmjet emrave dhe cilësive të Tij madhështore, po ashtu nëse e njeh Atë nëpërmjet madhështisë, fuqisë, urtësisë dhe dijes së Tij të plotë, atëherë të gjitha këto do ta realizojnë mundësinë që ta kryesh amanetin ndaj Allahut në mënyrën më të mirë.

2. Amaneti që lidhet me detyrimet ndaj Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, sepse gjithashtu na është lënë në amanet që t'i kryejmë edhe obligimet ndaj Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe ndër ato obligime është dashuria për të më tepër se vetveten dhe më tepër se çdo gjë tjetër. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Askush nuk ka besuar si duhet përderisa të mos jem më i dashur për të sesa prindi, fëmija dhe të gjithë njerëzit."* Kur Umeri i tha: "O i Dërguar i Allahut, pasha Allahun, ti je më i dashur për mua përpos vetes sime", Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Askush nuk ka besuar përderisa të mos jem më i dashur te ai më tepër se vetja e tij"*, dhe Umeri tha: "O i Dërguar i Allahut, pasha Allahun, tani je më i dashur për mua sesa vetja ime," Në fund Pejgamberi tha: *"Tani (ke besuar si duhet), o Umer!"*

Pra, amanet ndaj Pejgamberit është që ai të duhet me një dashuri e cila kërkon që të kryhen urdhrat dhe të ndalohet nga ndalesat e tij, t'u besohet fjalëve të tij, të respektohet dhe të nderohet si dhe të largohemi nga ekstremizmi ndaj tij. E tërë kjo është amanet ndaj Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem.

3. Amaneti që lidhet me detyrimet ndaj njerëzve, siç janë detyrimet ndaj prindërve, ndaj fëmijëve, fqinjëve, tregtarëve. Gjithashtu punëtorët dhe mësuesit kanë amanet, sepse çdonjëri ka amanetin në fushën ku vepron dhe Allahu do ta pyesë çdonjërin për amanetin që i ka dhënë, siç transmetohet në hadithin e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ku thotë:

"Çdo njeri nga ju është çoban dhe përgjegjës për kopenë e tij."

Robër të Allahut!

Kjo na e bën të qartë se amaneti nuk ka të bëjë vetëm me një fushë, siç mendojnë një pjesë e muslimanëve, se amaneti ka të bëjë vetëm me mbajtjen e fjalës dhe premtimit ndaj njerëzve. Jo, nuk është kështu, sepse amaneti është një përgjegjësi dhe obligim shumë i madh: një amanet lidhet me detyrimet ndaj Allahut, njeri me detyrimet ndaj Pejgamberit, kurse tjetri lidhet me detyrimet ndaj robërve të Allahut. Andaj, kini frikë Allahun dhe kryejeni amanetin ashtu siç duhet, mbajeni këtë përgjegjësi të madhe dhe kryejeni këtë obligim madhor dhe ta dini se Allahu do t'ju pyesë për të në ditën kur do të qëndroni përpara Tij:

"Atë ditë do të mbeten zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur." El Hakkah 18

Robër të Allahut! Përderisa jeni në botën e veprave, atëherë kini frikë Allahun dhe kryejeni amanetin ashtu siç duhet në të gjitha sferat e jetës, kërkojini ndihmë Allahut, sepse sa mbrojtës dhe sa ndihmues i mirë që është Ai.

Dr. Abdurrezak EL BEDER

Përshtati: Jeton BOZHLANI



NE DHE MORALI I TË DËRGUARIT

SAL-LALLAHU ALEJHI VE SEL-LEM

Morali i tij ishte Kur'ani. Aishja radijAllahu anha, kur është pyetur për moralin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Morali i tij ishte Kur'ani.” Ai u dërgua që të plotësonte normat e moralit ashtu siç ka treguar vetë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ku thotë: “Jam dërguar që të plotësoj normat e moralit.”

Falënderimet dhe lavdërimet tona janë vetëm për Allahun e Lartësuar, i Cili është i vetëm dhe pa shok, ndërsa salavatet dhe selamet ia dërgojmë krijesës më të dashur për Allahun, Profetit tonë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, familjes së tij të pastër, shokëve të tij të sinqertë dhe të gjithë atyre që e pasuan dhe e pasojnë rrugën e tij me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në shumë hadithe e ka nxitur ummetin e tij që të ketë cilësi dhe morale të larta. Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e bëri këtë pasi ai vetë ishte në një shkallë shumë të lartë të moralit, ashtu

siç e ka përshkruar Allahu i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë: **“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!”** El Kalem 4 Morali i tij ishte Kur'ani. Aishja radijAl-lahu anha, kur është pyetur për moralin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *“Morali i tij ishte Kur'ani.”*^[1] Ai u dërgua që të plotësonte normat e moralit ashtu siç ka treguar vetë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ku thotë: *“Jam dërguar që të plotësoj normat e moralit.”*^[2]

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke qenë se ishte njeriu më i moralshëm në të gjitha kohërat, i këshilloi dhe i porosi të tjerët që të jenë

[1] Transmeton Imam Ahmedi, Sahih el-Xhami' 4811.

[2] Transmeton Imam Ahmedi, Sahih el-Xhami' 2349.

të tillë në bindje, fjalë dhe vepra. Është transmetuar nga Ebu Dherri radijAllahu anhu se kishte kërkuar nga Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem që ta këshillonte, ndërsa ai i tha: *“Ki frikë Allahun kudo që të jesh, veprën e keqe përcille me të mirë, se e fshin atë. Dhe me njerëzit sillu me moral të mirë.”*^[3]

Po ashtu është transmetuar nga Ebu Umamete radijAllahu anhu, se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Unë i garantoj një shtëpi në periferinë e xhennetit atij që e lë polemikën edhe nëse ka të drejtë, një shtëpi në mes të xhennetit atij që e lë gënjeshtërën edhe nëse është duke bërë shaka dhe një shtëpi në pjesën më të lartë të xhennetit atij që ka moralin më të mirë.”*^[4]

Aishja radijAllahu anha ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *“Njeriu me moralin e tij të mirë arrin gradën e atij që agjëron dhe falet (vazhdimisht).”*^[5]

Po ashtu është transmetuar nga Ebu Der-dai radijAllahu anhu se vërtet Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Nuk ka asgjë më të rëndë në peshoren e muslimanit Ditën e Kiametit se morali i mirë dhe se vërtet Allahu e urren të paturpshmin.”*^[6]

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem vazhdimisht i lutej Allahut të Lartësuar që ta udhëzonte në moral të lartë. Ai thoshte: *“...Dhe më udhëzo mua në moralin më të mirë sepse nuk udhëzon në moralin më të mirë vetëm se Ti dhe largo nga unë amoralitetin ngase nuk mund ta largojë vetëm se Ti...”*^[7]

Allahu i Lartësuar ka treguar në Kur'anin Famëlartë se shembulli më i mirë për ne është Profeti sal-lAllahu alehi ve sel-lem dhe njëherazi na ka obliguar që ta pasojmë dhe ta marrim si shembull në jetën tonë. Allahu i Lartësuar në Kur'an thotë:

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” El Ahzab 21

Pasi ne besojmë Allahun dhe Ditën e Fundit dhe shpresojmë tek Allahu që të na përfshijë me Mëshirën e Tij të pa-fund, atëherë duhet të kemi moral të lartë duke pasur si prijës dhe shembull Profetin tonë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ashtu si na porositi Allahu i Lartësuar në këtë ajet kur'anor.

Për të fituar mëshirën dhe faljen e Allahut të Lartësuar në këtë dhe në botën tjetër, njeriu duhet që të jetë i singertë në besimin, fjalët dhe veprat e tij ngase me këto morale të larta ishte pajisur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Për këtë dëshmonin edhe armiqtë e tij para se të dëshmonin shokët e tij, prandaj ai quhej prej tyre “i singerti, i drejti”. Si të mos ishte kështu kur ai vazhdimisht i porosiste të tjerët që të jenë të singertë dhe besnikë?! Abdullah ibën Mesudi radijAllahu anhu tregon se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“(Bëhuni të singertë se) Vërtet singëriteti të shpie në mirësi dhe mirësia pa dyshim të shpie në xhennet. Njeriu vazhdon të jetë i singertë (në fjalë dhe vepra) derisa të shkruhet tek Allahu i singertë (besimtar i vërtetë). Ndërsa gënjeshtra vërtet të shpie në*

[3] Transmeton Imam Ahmedi, Sahih el-Xhami' 97.

[4] Sahih ve Daif Sunen ebi Davud 4800 (Hasen)

[5] Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

[6] Sahih ve Daif Sunen et-Tirmidhij 2002 (Sahih).

[7] Transmeton Muslimi 771.

shthurje (paturpësi)dhe s'ka dyshim se shthurja të shpie në xbehennem. Njeriu vazhdon të gënjejë derisa të shkruhet tek Allahu gënjeshtar i madh.”^[8]

Nëse dëshirojmë që në botën tjetër të përfundojmë në xhennet, atëherë patjetër duhet të jemi të sinqertë në bindje, fjalë dhe vepra ngase kjo është edhe porosia e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili na ka treguar se myslimani që vepron kështu do të ketë përfundim të mirë në botën e përjetësisë.

Çdo musliman që ka besuar Allahun dhe Ditën e Kiametit duhet të jetë me moral të lartë, duhet ta ketë frikë Allahun në çdo gjë, qoftë ajo bindje, fjalë apo vepër në mënyrë që të llogaritet si i sinqerti, ashtu siç ka porositur Allahu i Lartësuar në librin e Tij: ***“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!”*** Et Tevbe 119

Nga morali i të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte edhe falja, një cilësi shumë e çmuar tek Allahu i Lartësuar. Xhabiri radijAllahu anhu tregon se në një nga betejat ku kishte marrë pjesë bashkë me Profetin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nga ana e Nexhdit, duke u kthyer i zuri koha e kajlules (koha para drekës) në një luginë me shumë pemë. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u ndal aty dhe njerëzit u shpërndanë nëpër hije. Edhe i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u ulë nën hijen e një peme, vari shpatën e tij në pemë dhe e kapi gjumi. Më pas (tregon Xhabiri radijAllahu anhu), na thirri i Dërguari i Allahut

sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe tek ai ishte një njeri. Më pas na tregoi: *“Vërtet ky njeri e mori shpatën time derisa isha duke fjetur. Kur u zgjova, e pashë në dorën e tij, i gatsbëm për të më goditur. Më tha: - Kush më ndalon (që të të vras)? Unë i thashë: Allahu, tri herë dhe ja tani ku është ulur.” Nuk e dënoi i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem atë.”*^[9]

Në një transmetim tjetër ka ardhur: *“I ra shpata nga dora e tij dhe më pas e mori i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: “Kush më ndalon mua (që të të vras)? Ai tha: -Bëhu marrësi më i mirë (d.m.th. më fal).” Atëherë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i tha: “A dëshmon se nuk meriton askush të adhurohet veç Allahut dhe se unë jam i Dërguar i Tij?” Tha: “Jo, por të jap besën që nuk do të luftoj kurrë kundër teje dhe nuk do të jem me atë popull që të lufton ty.” Atëherë e liroi. Njeriu shkoi te sahabët dhe u tha: -Povij nga njeriu më i mirë.”*^[10]

Ky ishte Profeti ynë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe kjo është feja e tij, me të cilën Allahu e dërgoi të na mësojë ne. Ku janë zërat e atyre që shpifin se feja islame është përhapur me forcë dhe me tehun e shpatës?! Këtë njeri, edhe pse nuk e pranoi fenë e Allahut, Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem prapë e fali duke mos e keqtrajtuar fare. Këto janë argumente të qarta për ata që mendojnë. Ky rast është një argument tjetër se vërtet Kur’ani ishte morali i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ngase Allahu i Lartësuar thotë: ***“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa***

[8] Muttefekun alejhi.

[9] Transmeton Buhariu 4135, muslimi, 843.

[10] Transmeton imam Ahmedi, 15190.

qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”
Alu Imran 134-135

Si të mos jetë Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i mëshirshëm për këtë person kur ai ishte dërguar që të plotësonte normat e moralit dhe si mëshirë për mbarë njerëzimin?! Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”** El Enbija 107

Pjesë e moralit të të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte edhe modestia dhe bujaria, madje çdo gjë që posedonte e jepte në rrugën e Allahut të Lartësuar. Ibën Abasi radijAllahu anhumu ka thënë: **“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte më bujari ndaj njerëzve në punë të mira...”** [11]

Aishja radijAllahu anha transmeton se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem **“kujdesej për nallanet e tij, qepte rrobat e tij dhe punonte në shtëpinë e tij ashtu si punon ndonjëri nga ju në shtëpinë e vet.”** [12]

Abdullah ibën ebi Evfa radijAllahu ka thënë: **“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e përmendte shumë Allahun, shmangej nga fjalët e kota, e zgjaste namazin, e shkurtonte hudben dhe nuk kundërshtonte të shkonte me ndonjë të mjerë apo të ve që të kryente punët e tyre.”** [13]

Ky ishte morali i të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ku janë ata që pretendojnë se pasojnë rrugën e tij dhe se e duan atë? Pasimi i rrugës së tij dhe

dashuria për të duhet të jetë me bindje, fjalë dhe vepra ashtu siç na ka mësuar ai. Është obligim i çdo muslimani ndaj të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem që të pasojë rrugën e tij, ta jetojë tërë jetën e tij saktësisht sipas asaj që na mësoi Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nëse dëshiron shpëtim në këtë botë dhe në tjetrën. Kini frikë Allahun dhe bëhuni të moralshëm, ngase do të vijë një ditë kur që të gjithë do të përgjigjen për sjelljet dhe veprat e tyre, një ditë e cila do të jetë e vështirë për të pamoralshmit, një ditë në të cilën nuk do të ketë padrejtësi, miqësi dhe lidhje farefisnore, një ditë ku nuk do të bëjë dobi as malli e as evlati, por vetëm zemra e pastër e mbushur me iman dhe me moral të lartë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe ruajuni asaj dite që do të ktheheni tek Allahu, kur çdokujt do t’i jepet ajo që ka fituar dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”** El Bekare 281

E lusim Allahun e Lartësuar që të na bëjë prej atyre që i dëgjojnë fjalët e mira dhe i pasojnë ato, i dëgjojnë fjalët e liga dhe largohen prej tyre dhe që të na bëjë të moralshëm në bindje, fjalë dhe vepra! Vërtet Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë!

Përgatiti: **Sabahudin SELIMI**
Viti/ Kosovë

[11] Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

[12] Transmeton imam Ahmedi 24903.

[13] Sahihi ve Daif Sunen en-Nesai 1414 (Sahih).



MË E MIRA QË ËSHTË THËNË PËR TY MOTËR (II)

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Nëse gruaja fal pesë kohët e namazit, agjëron Ramazanin, e ruan nderin e saj, i bindet burrit të saj, i thuhet hyr në xhennet nga cila derë të duash."

MMe të vërtetë falënderimi i takon vetëm Allahut. Prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Paqja dhe mëshira qoftë mbi të dashurin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij në përgjithësi. Për çdo motër që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Për çdo motër që dëshiron shpëtim dhe shpreson fitore dhe qetësim. Për çdo motër që ka përqafuar metodën e thjeshtësisë duke mos u mashtruar pas fjalëve të bukura.

Për çdo motër që do të dijë obligimet e të tjerëve ndaj saj dhe të saj ndaj të tjerëve. Për çdo motër që ëndërron të arrijë nderin dhe moralin më të lartë, që të jetë edukuese dhe përmirësuese e gjendjes.

Kështu flet libri i Allahut, që thotë vetëm të vërtetën, dhe Sunneti i të Dërguarit të Tij, që e zbukuron atë të vërtetë me urtësi dhe butësi.

Motër e nderuar dhe e respektuar, dëgjo fjalën më të mirë që është thënë për ty nga Allahu dhe i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

11 Mirësjellja

Allahu në Kur'an thotë: *"Jetoni e sil-luni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duron) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t'ju sjellë shumë të mira."* En Nisa 19

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kini frikë Allahun ndaj grave tua, ngase i keni amanet nga ana e Allahut dhe u është lejuar marrëdhënia me to në emër të Allahut."*^[1]

12 Vendqëndrimi

Allahu në Kur'an thotë: *"Qëndroni në shtëpitë tua."* El Ahzab 33

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Çdo grua që zhvesh rrobat e saj jashtë shtëpisë së burrit, vetëm se ka larguar mbrojtjen e Allahut prej saj."*^[2]

"Gruaja është avret, nëse ajo del nga shtëpia, i vërsulet shejtani."^[3]

13 Zhveshja

Allahu në Kur'an thotë: *"... e mos i zbuloni stolitë tua, ashtu siç zbulon*

heshin në kohën e padijes." El Ahzab 33

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Dy grupe njerëzish prej banorëve të zjarrit nuk i kam parë akoma; disa burra që mbajnë shkopinj si bishtat e lopëve e godasin njerëzit me ta dhe gra që janë të veshura por të zhveshura, përdridhen dhe bëjnë njerëzit të dridhen, kokat e tyre janë si gungat e deveve të dobëta, nuk kanë për të hyrë në xhennet dhe nuk do ta ndiejnë aromën e tij, edhe pse ajo ndihet nga një largësi e madhe."*^[4]

14 Provokimet

Allahu në Kur'an thotë: *"... mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër ephshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"* El Ahzab 32

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nuk kam lënë provokim më të rrezikshëm për meshkujt e ummetit tim sesa femrën."*^[5]

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Unë nuk përshëndetem për dore me gra (të huaja)."*^[6]

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kini kujdes nga kjo botë*

[1] Muslimi.

[2] Transmeton Ahmedi, e ka sakësuar Albani.

[3] Transmeton Tirmidhiu, e ka sakësuar Albani.

[4] Muslimi.

[5] Mutefekun alejhi.

[6] Transmeton Tirmidhiu dhe e ka sakësuar Albani.

dhe nga gratë, ngase sprova e parë e Beni Israilëve ishte në gra.”^[7]

15 Ndershmëria

Allahu në Kur'an thotë: *"Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre."* En Nur 31

Pastaj Allahu në Kur'an thotë: *"Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta."* En Nur 31

Ata ibën ebi Rrebah thotë: *"Tbën Abasi radijAllahu anhumā më ka thënë: -A të të tregoj për një grua nga banorët e xhenetit? I thashë po. Tha: -Kjo gruaja zeshkane ka ardhur tek i Dërguari i Allahut dhe i ka thënë: -Unë jam grua që alivanosem shpeshherë dhe zbulohem pastaj, kështu që lute Allahun për mua. Tha: "Nëse do, bëj sabër dhe ke xhenetin e nëse do, e lus Allahun për shërim." Ajo tha: -Dua sabrin, por lute Allahun të mos zbulohem. Dhe i Dërguari e luti Allahun për këtë."*^[8]

^[7] Muslimi.

^[8] Mutefekun alejhi.

16 Respekti, adhurimi dhe përmendja e Allahut

Allahu në Kur'an thotë: *"Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij!"* El Ahzab 33

"Mbani në mendje ato që lexohen në shtëpitë tuaja prej shpalljes së Allahut dhe urtësisë (profetike)!" El Ahzab 34

"Me të vërtetë që për muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të singertët) dhe të drejtat (të singertat), duruesit dhe durueset, të përulurit dhe të përulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh." El Ahzab 35

17 Gruaja e moshuar

Allahu në Kur'an thotë: *"Gratë e vjetra, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke treguar stolitë e tyre. E, nëse përmbahen, është edhe më mirë për ato. Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha."* En Nur 60

18 Pranim dhe nënshtrim

Allahu në Kur'an thotë: *"Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre."* El Ahzab 36

19 Mbrojtja e gruas

Allahu në Kur'an thotë: *"Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu."* En Nisa 34

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nëse gruaja fal pesë kohët e namazit, agjëron Ramazanin, e ruan nderin e saj, i bindet burrit të saj, i thuhet hyr në xhennet nga cila derë të duash."* [9]

20 Shpenzimet

Allahu në Kur'an thotë: *"Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre."* En Nisa 34

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi

ve sel-lem ka thënë: *"Dinari që shpenzohet për hir të Allahut, dinari që shpenzohet për lirim të një rob, dinari që shpenzohet për sadaka ndaj të varfërve dhe dinarin që e shpenzon për familjen e tij, peshën më të madhe e ka dinari për familjen tënde."* [10]

Ka thënë Muavije Ibën Hajdete: *"O i Dërguar i Allahut! Cili është obligimi ynë ndaj grave tona?" Tha: "Ta ushqesh nëse është e uritur, ta veshësh me rroba, mos ta godasësh në fytyrë, mos ta urresh, mos ta bojkotosh vetëm se në shtëpi."* [11]

Më e mira që është thënë për ty motër

Përshtati: **Unejs MURATI**
Gjilan / Kosovë

[9] Transmeton Ahemdi, e sakësoi Albani.

[10] Muslimi.

[11] Transmetojnë Ebu Davudi, Nisaiu dhe e sakësoi Albani.



VLERA E LËMOSHËS NDAJ TË VARFËRVE

Ai tha: -Pasi e the këtë, po të tregoj. E mbledh atë që del nga ky kopsht dhe një të tretën e jap sadaka, një të tretën e lë për vete dhe familje dhe një të tretën e fundit e shpenzoj në mbjelljen e kopshtit prapë."

Këto janë disa çështje besimi në të cilat ka mësim, këshilla dhe shembuj. Jemi në çështjen e tridhjetetretë nga çështjet e besimit. A e dini se cila është ajo, o robër të Allahut? Dhënia sadaka-lëmoshë me sinqeritet ndaj të varfërve dhe të mjerëve. Robër të Allahut!

1. Jepni lëmoshë nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase lëmosha ka një rëndësi madhështore në Ditën e Kiametit, këtë ditë kur njerëzit të dalin nga varret e tyre, zbathur të zhveshur dhe të pabërë synet, në nxehtësi dhe turmë të madhe, do të vendosen peshoret dhe do të zbresë Zoti i Lartmadhërisëm për gjykimin e robërve të Tij, që t'i dënojë ata që bënë vepra të liga dhe t'i shpërblejë ata që bënë të mira.

O bir i Ademit!

Mendo për qëndrimin tënd ditën kur do të paraqitesh i zhveshur, i vetmuar e pikëlluar dhe i pafuqishëm, kur zjarri tërbues dhe irritues përfshin mëkatarët dhe Zoti i Fronit është i zemëruar. Ai thotë: **"O rob! Im, lexo librin tënd pa nxitim, a po has në të ndonjë gjë që s'ke vepruar?"** Pse e lexove atë dhe nuk e kundërshtove leximin e tij, por e pranove vendimin e Atij që i di gjërat me dituri të përsosur? I Lartësuar i thotë: -Merreni këtë o melaiket e Mia dhe dërgojeni në zjarrin e etur për shkak të kundërshtimit! Zullumqarët të nesërmen në zjarr do të digjen, ndërsa besimtarët do të jenë në shtëpinë e përjetësisë (xhennet). Në këtë vend të tmerrshëm dhe ditë të

vështirë lëmosha do të ketë një rëndësi madhështore, ngase bamirësi këtë ditë do të jetë nën hijen e lëmoshës së tij, derisa Allahu të gjykojë mes robërve.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ditën e Kiametit çdokush do të jetë nën hijen e sadakasë së tij, derisa të gjykohej njerëzit."*^[1]

Gjithashtu ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Hije e besimtarit Ditën e Kiametit do të jetë sadakaja e tij."*^[2]

2. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Ai ju furnizoi, ngase Ditën e Kiametit ai që jep lëmoshë ndaj të varfërve dhe të mjerëve do të jetë nën hijen e Fronit të Mëshiruesit.

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Shtatë lloje njerëzish do të hyjnë nën hijen e Allahut atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së (Arshit-Fronit) Tij: udhëheqësi i drejtë, i riu që është rritur në adhurim dhe i është nënshtruar Allahut, njeriu zemra e të cilit është e lidhur ngushtë me xhamitë, dy njerëz që duhen mes vete për hir të Allahut, shoqërohen dhe ndahen për hir të Tij, njeriu të cilin e thërret (për amoralitet) një grua e bukur dhe me pozitivitet dhe ai i përgjigjet unë i frikësohem Allahut, Sunduesit të botëve, njeriu që jep lëmoshë fshehurazi sa që dora e majtë të mos e dijë ç'jep e djathta, njeriu që përmend Allahun në vetmi dhe sytë i rrjedhin lot."*^[3]

3. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Ai ju furnizoi, ngase lëmosha do t'ju ruhet tek Allahu i Lartësuar. E kultivon atë për ju dhe kujdeset për të me të Djathtën e Tij, derisa të arrijë madhësinë e kodrave.

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka

thënë: *"Kush jep lëmoshë me një shumë sa një hurme nga pasuria e pastër, dhe Allahu pranon vetëm atë që është e pastër, vërtet Allahu e pranon atë me të djathtën e Tij dhe kujdeset për të ashtu si kujdeset ndonjëri nga ju për familjen e tij derisa të arrijë madhësinë e kodrës."*^[4]

Ajo që është tek ju është kalimtare, ndërsa ajo që është tek Allahu është e përgjeshme. Allahu i Lartësuar ka treguar në Librin e Tij se është Ai që e pranon lëmoshën. Allahu i Lartësuar thotë: *"A nuk e dinë ata se Allahu është Ai që pranon pendimin dhe sadakanë-bamirësinë nga robërit e Vet dhe se Ai është Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti?"* Et Tevbe 104

Po ashtu thotë: *"Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e sadakasë-bamirësisë."* El Bekare 276

4. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Ai ju furnizoi, ngase lëmosha është shkak për faljen e mëkateve dhe arrin shpërblim të madh tek Allahu.

Allahu i Lartësuar thotë: *"Me të vërtetë që për muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtare..."* deri te fjalët: *"mirëbërësit dhe mirëbërëset..."* D.m.th: mirëbërësit nga burrat dhe gratë, çfarë ka përgatitur Allahu i Lartësuar për ta, përfundon ajeti: *"...pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh."* El Ahzab 35

Gjithashtu Allahu thotë: *"Ata që japin lëmoshë e që i japin Allahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t'u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik."* El Hadid 17

5. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase lëmosha e

[1] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 872.

[2] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 523.

[3] Muttefekun alejhi.

[4] Muttefekun alejhi.

pastron shpirtin dhe pasurinë. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira!”*** Et Tevbe 103

6. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase pasuria në dorën tënde do të shtohet për shkak të lëmoshës.

I Dërguari sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Për tri gjëra betohem: nuk pakësohet pasuria e ndonjërit prej jush nga lëmosha...”*^[5]

Gjithashtu thotë: *“Nuk ka ditë që robërit ngrihen në mëngjes, vetëm se dy melekë zbresin dhe njëri prej tyre thotë: -O Zot, atij që jep lëmoshë zëvendësoja! Ndërsa tjetri thotë: -O Zot, atij që nuk jep (lëmoshë) jepi humbje!”*^[6]

Allahu i Lartësuar thotë: ***“Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë.”*** Sebe’ 39

O robër të Allahut, kush jep për të varfrit dhe të mjerët pa dyshim se Allahu i Lartësuar do t’ia zëvendësojë këtë. Bamiressit nga radhët tuaja e dinë mirë këtë.

7. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase lëmosha shuan zemërimin e Zotit. I Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Lëmosha fshehurazi shuan zemërimin e Zotit, lëmosha ndaj të afërmve zgjat jetën, ndërsa të punuarit e së mirës largon nga të ligat.”*^[7]

8. O robër të Allahut, jepni lëmoshë nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase lëmosha i fshin mëkatet. I Dërguari sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i tha Muadhrit radijAllahu

anhu: *“A do të të tregoj për dyert e hajrit? Agjërimi është mburojë, lëmosha i shuan mëkatet ashtu si uji shuan zjarrin dhe namazi i njeriut në thellësi të natës.”*^[8]

9. O robër të Allahut, jepni nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase lëmosha e shuan nxehtësinë e varrit për dhënësit e saj. I Dërguari sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Vërtet lëmosha e shuan nxehtësinë e varrit për dhënësit e saj dhe vërtet besimtari në Ditën e Kiametit do të jetë nën hijen e lëmoshës së tij.”*^[9]

10. O robër të Allahut, jepni nga ajo që Allahu ju furnizoi, ngase lëmosha shpëton nga dënimi i zjarrit. I Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Nuk ka asnjë nga ju vetëm se do t’i flasë Allahu në Ditën e Kiametit dhe mes Allahut dhe tij nuk do të ketë përkthyes. Shikon në të djathtën e tij nuk sheh tjetër vetëm se atë që ka punuar, shikon në të majtën e tij dhe nuk sheh vetëm se atë që ka punuar, shikon para tij dhe nuk sheh vetëm se zjarrin në drejtim të fytyrës së tij. Kini frikë zjarrin qoftë edhe me gjysmë hurme apo me një fjalë të mirë.”*^[10]

Ai sal-IAllahu alejhi ve sel-lem gjithashtu thotë: *“Bëni mes jush dhe zjarrit pengesë qoftë edhe me një gjysmë hurme.”*^[11]

Robër të Allahut, lëmosha është shumë me vlerë dhe ka shpërblim të madh, prandaj në Kur’an dhe Sunnet ka ardhur urdhri për ta dhënë atë. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira!”*** Et Tevbe 103

Gjithashtu thotë: ***“...jepuni diçka nga pa-***

[5] Sahih El-Xhami’.

[6] Sahih El-Xhami’.

[7] Sahih El-Xhami’.

[8] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 1/520.

[9] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 873.

[10] Sahih El-Xhami’.

[11] Sahih El-Xhami’.

suria jua, të cilën ju ka dhuruar Allahu..."

En Nur: 33

Si dhe: *"...dhe shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim, se për ata midis jush që besojnë dhe shpenzojnë (për bamirësi), do të ketë shpërblim të madh!"* El Hadid: 7

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Jepni lëmoshë para se (të vijë dita) të mos mund të jepni."*^[12]

Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i urdhëroi shokët e tij që të japin lëmoshë nga ajo që posedonin, saqë i urdhëroi që të japin lëmoshë qoftë edhe me gjysmë hurme. Sot ka jetë, por nesër do të ketë vdekje, nëse nuk jep lëmoshë nga ky moment a do të japësh lëmoshë kur trupin tënd të pajetë ta bartin për në varr?!

Jepni lëmoshë para se të ballafaqoheni me fitne si pjesët e errëta të natës, kur të goditeni nga këto fitne me koprraci të madhe që ju pengojnë të jepni lëmoshë.

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Jepni lëmoshë, ngase do të vijë një kohë kur njeriu kërkon kujt t'i japë lëmoshë dhe ai që dëshiron t'i japë thotë "sikur të vije dje, do ta pranoja këtë lëmoshë prej teje, por tani nuk kam nevojë për të" dhe kështu nuk do të gjejë askënd që e pranon atë."*^[13]

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"O ju tregtarë! Kjo shitblerje përcillet me gabime dhe betime (jo të drejta), atëherë përmirësojeni atë duke dhënë lëmoshë."*^[14]

Po ashtu ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"O ju gra, jepni lëmoshë nga stolitë tuaja, ngase ju vërtet jeni shumica e banorëve të xhehenemit Ditën e Kiametit."*^[15]

Robër të Allahut, lëmosha është dy llojesh: lëmosha obligative dhe ajo e prefer-

uar. Lëmosha obligative është zekati, ashtu siç na ka urdhëruar Allahu me nxjerrjen e tij dhe ka paralajmëruar mosdhënësin e tij. Zekati është në para, bagëti, bujqësi etj. Allahu i Lartësuar si qortim për mosdhënësin e zekatit ka thënë:

"...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t'u thuhet: "Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!" Et Tevbe 34-35

I Dërguari ynë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem na e sqaroi këtë ajet kur'anor me fjalët e tij, kur thotë: *"Nuk ka njeri i cili posedon ar apo argjend dhe nuk e nxjerr hakun që i takon nga ato (zekatin), Ditën e Kiametit do t'i bëhen pllaka nga zjarri dhe do të skuqen në zjarr të xhehenemit e me to do t'i fërkohen anët, balli dhe shpina e tij, sa herë që të ftohen do të rikthehen në zjarr"...*në ditën, gjatësia e së cilës është një mijë vjet sipas llogaritjes suaj". Kështu do të ndëshkohet derisa të përfundojë gjykimi mes njerëzve e më pas i bëhet e qartë rruga e tij, ose për në xhenet ose për në zjarr."^[16]

O ti i pasur që ke ndalur zekatin, a ke mundësi ta përballosh këtë dënim?

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Kujt Allahu i jep pasuri dhe nuk e nxjerr zekatin nga ajo, Ditën e Kiametit (kjo pasuri) do t'i shndërrohet në një gjarpër pa qime (në kokë, i madh dhe shumë helmues), i cili ka dy mbajtës helmi. Ditën e Kiametit do ta mbështjellë atë dhe e kap me dy nofullat e tij, më pas i thotë: -Unë jam*

[12] Sahih El-Xhami'.

[13] Sahih El-Xhami'.

[14] Sahih El-Xhami'.

[15] Sahih El-Xhami', 7981.

[16] Sahih El-Xhami', 5729.

pasuria jote, unë jam thesari yt!”^[17] Më pas ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem citoi fjalët e Allahut: “Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, kurrësi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar do t’u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kiametit.” Alu Imran: 180

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë gjithashtu: “Kush nuk jep zekatin, Ditën e Kiametit do të jetë në zjarr.”^[18]

Dhe: “Nuk ka popull që e ka ndaluar dhënien e zekatit vetëm se i ka sprovuar Allahu me varfëri dhe thatësi.”^[19]

Si dhe: “Nuk ka popull që e ka ndaluar dhënien e zekatit vetëm se Allahu ia ka ndaluar shiun.”^[20]

Robër të Allahut, ejani me ne që të mësojmë sinqeritetin në nxjerrjen e lëmoshës nga një njeri i mirë, i cili nuk kishte ndonjë preokupim tjetër vetëm se dhënien e lëmoshës me qëllim të pastër dhe kështu Allahu e pranoi lëmoshën e tij dhe prej kësaj përfitoi edhe ai që mori lëmoshën.

1- I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Një njeri ka thënë: - Në këtë natë do të jap një lëmoshë. Doli që të japë atë dhe ia dorëzoi një gruaje që bënte amoralitet. Të nesërmen filluan të flasin (të tjerët): -Mbrëmë i është dhënë lëmoshë një zinaqareje. Ai tha: -O Allah, Ty të takon falënderimi për këtë zinaqare, prapë do të jap lëmoshë. Doli që ta japë atë dhe ia dorëzoi një të pasuri. Të nesërmen prapë filluan të flasin, se mbrëmë i është dhënë lëmoshë një të pasuri. Ai tha: -O Allah, Ty të takon

falënderimi për të pasurin, prapë do të jap lëmoshë. Doli që ta japë lëmoshën e tij dhe ia dha një hajduti. Të nesërmen prapë filluan të flasin, se mbrëmë i është dhënë lëmoshë një hajduti. Ai tha: -O Allah, Ty të takon falënderimi për zinaqaren, të pasurin dhe hajdutin. Më pas i erdhi një (i panjohur) dhe i tha: -Lëmosha që ke dhënë të është pranuar. Sa i përket zinaqares, ndoshta (kjo lëmoshë) e bën që të largohet nga zinaja, ndërsa i pasuri ndoshta merr shembull dhe jep nga ajo që Allahu e ka furnizuar dhe ndoshta hajduti mjaftohet me lëmoshën dhe largohet nga vjedhja.”^[21]

2- I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Derisa një njeri ishte duke ecur në shkretëtirë të hapur, dëgjoji një zë nga retë: - Ujite kopshtin e filanit. Kjo re filloi të lëvizte derisa arriti te një tokë me shumë gurë të zi dhe lëshoi ujin dhe kështu një kanal nga kanalet e ujitjes e mori të gjithë ujin dhe ky filloi të shkojë pas ujit. Më pas pa një njeri në kopshtin e tij duke e orientuar ujin në hapësirën (e kopshtit). I tha: -O rob i Allahut! Si të quajnë? Ai ia ktheu: -Filani dhe i përmendi emrin që kishte dëgjuar në re. Më pas i tha: -O rob i Allahut, pse më pyet për emrin tim? Ai i tha: -Vërtet kam dëgjuar një zë në re, uji i së cilës është ky duke thënë: -Ujite kopshtin e filanit, saktësisht me emrin tënd. Atëherë çfarë bën ti me këtë kopsht?

Ai tha: -Pasi e the këtë, po të tregoj. E mbledh atë që del nga ky kopsht dhe një të tretën e jap sadaka, një të tretën e lë për vete dhe familje dhe një të tretën e fundit e shpenzoj në mbjelljen e kopshtit prapë.”^[22] Shikoni robër të Allahut, një urdhër nga

[17] Muttefekun alejhi.

[18] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 762.

[19] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 763.

[20] Sahih Et-Tergib vet-Terhib, 763.

[21] Transmeton Muslimi.

[22] Transmeton Muslimi.

Allahu për renë, që të ujitë kopshtin e filanit në veçanti. Cili prej nesh e bën këtë o umeti islam? Për shembull, nëse njëri nga ne ka një lokal ose fabrikë etj., dhe Allahu i Lartësuar e furnizon përmes saj me treqind mijë (euro), ai thotë: -Njëqind mijë i ndaj për të varfrit, njëqind mijë për vete dhe familjen dhe njëqind mijë të fundit i investoj prapë në fabrikën apo tregtinë time. Kush prej nesh e bën këtë?

Robër të Allahut, nëse vështrojmë muslimanët në këtë kohë, shumica nuk e nxjerrin zekatin e pasurisë së tyre, të cilin Allahu e ka bërë obligim, përveç atyre që i ka mëshiruar Allahu.

3- Ebu Talha el-Ensarij radijAllahu anhu ishte nga më të pasurit e ensarëve në Medinë, kur dëgjoji që Allahu i ka shpallur të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem fjalët: ***“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni.”*** Alu Imran 92

Shkoi tek i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: ***“O i Dërguari i Allahut, vërtet Allahu i Lartësuar të ka shpallur fjalët: “Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni?”*** Pasuria më e dashur për mua është Bejreha (një kopsht), kjo nga sot është lëmoshë për Allahun e Lartësuar. Shpresoj shpërblimin e saj tek Allahu i Lartësuar (në botën tjetër). O i Dërguar i Allahut, shpërndaje ku ta cakton Allahu.” I Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem tha: ***“Të lumtë, kjo është pasuri fitimprurëse, kjo është pasuri fitimprurëse, unë dëgjova atë që the dhe mendoj që ta shpërndash te të afërmit.”***

Atëherë Ebu Talha tha: “Do ta bëj, o i Dërguari i Allahut”, dhe e ndau mes të afërmeve dhe bijve të xhaxhallarëve të tij.”^[23]

Robër të Allahut, mësimet dhe shembujt që merren nga këto ngjarje janë si në vijim:

1. Singëriteti në dhënien e lëmoshës.

Mendoje këtë njeri që tha: -Këtë natë do të jap lëmoshë dhe i dha lëmoshë një gruaje amorale, pastaj një të pasuri dhe një hajduti. Allahu e pranoi lëmoshën e tij dhe ata që morën lëmoshën përfituan. E gjithë kjo është si rezultat i singëritetit që kishte në dhënien e lëmoshës. Jepni lëmoshë o robër të Allahut, por jo me syfaqësi dhe lëvdata.

2. Nxjerrja e lëmoshës fshehurazi.

Nuk do ta dinte askush për lëmoshën që dha ky njeri sikur të mos tregonte i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, ashtu siç ia kishte shpallur Allahu i Lartësuar.

Edhe për njeriun që jepte lëmoshë një të tretën e frutave që merrte nga kopshti i tij askush nuk e dinte. Lëmosha fshehurazi është shkak i arritjes së bereqetit dhe shkak për pranimin e lëmoshës. Allahu i Lartësuar thotë: ***“T’i jepni lëmoshat hap-tazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë...”*** El Bekare 271

3. Mospërmendja e lëmoshës ndaj të varfërve.

Mos thuaj kam vepruar kështu, kam dhënë lëmoshë kështu, por bëje vetëm për Allahun e Lartësuar e të Madhërishëm. Allahu Fuqiplotë thotë: ***“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar***

[23] Muttefekun alejhi.

*ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke
fyer...*”El Bekare 264

Robër të Allahut!

Lëmoshë është edhe ajo që nxirret në përfundimin e muajit Ramazan (sadakatul-fitër), para namazit të Bajramit. Dhënia e kësaj lëmoshe është obligim për çdo musliman, qoftë i pasur apo i varfër, burrë apo grua, i lirë apo rob.

Në hadithin e ibën Umerit radijAllahu anhumâ është thënë: *“I Dërguari i Allahut sal-Lallahu alejhi ve sel-lem e ka bërë obligim sadakatul-fitrin (vitrat) një sa’^[24] nga hurmat ose nga elbi për çdo rob dhe të lirë, mashkull apo femër, të rritur apo të mitur nga muslimanët dhe urdhëroi që të jepet para se njerëzit të dalin për namaz (të Bajramit).”*^[25]

2. Urtësia në këtë lëmoshë është pastrimi për agjëruesin nga gabimet e turpësitë dhe në anën tjetër ushqim për të varfrit dhe të mjerët, ashtu si ka ardhur në hadithin e ibën Abasit radijAllahu anhumâ.

3. Koha e saj: Kjo lëmoshë jepet në fund të muajit Ramazan, para namazit të Bajramit. Pra, kush e jep para namazit të Bajramit i llogaritet sadakatul-fitër, ndërsa kush e jep pas namazit të Bajramit i llogaritet si lëmoshë e përgjithshme.

Ibën Umeri radijAllahu anhumâ thotë: *“I Dërguari i Allahut sal-Lallahu alejhi ve sel-lem ka urdhëruar që sadakatul-fitri të jepet para se të dalin njerëzit për namaz (të Bajramit).”*^[26]

4. Sasia: Ebu Seid el-Hudriju radijAllahu anhu ka thënë: *“Ne jepnim sadakatul-fitrin një sa’ nga ushqimi, nga elbi, hurmat, djathi apo nga rrushi i thatë.”*^[27]

[24] Njësi matëse tek arabët.

[25] Muttefekun alejhi.

[26] Muttefekun alejhi.

[27] Muttefekun alejhi.

Të gjithë dijetarët janë të pajtimit që sadakatul-fitri duhet patjetër të nxirret nga ushqimet dhe nuk vlen të nxirret vlera e saj me përjashtim të Ebu Hanifes, Allahu e mëshiroftë, i cili ka mendimin se mund të jepet vlera e ushqimit në para. Mendimi i saktë qëndron me shumicën e dijetarëve, të cilët mendojnë se sadakatul-fitri vlen vetëm si ushqim, ngase Profeti sal-Lallahu alejhi ve sel-lem e bëri obligim një sa’ nga ushqimi, edhe pse në atë kohë ishte prezente monedha dhe nevoja për të. Ushqimi që mund të nxirret tek ne tani është orizi. Një sa’ është afërsisht dy kilogramë e gjysmë.

Është obligim për çdo musliman që ta ketë frikë Allahun dhe të kapet pas Sunnnetit të Profetit sal-Lallahu alejhi ve sel-lem, duke e dhënë sadakatul-fitrin për veten e tij dhe për të gjithë ata që ka nën mbikëqyrjen e tij në fund të muajit Ramazan, duke e pastruar kështu veten nga gabimet e turpësitë dhe njëherazi t’u sigurojë ushqim skamnorëve.

O Zoti ynë, na bëj të qartë të vërtetën dhe mundësona pasimin e saj dhe na e bëj të qartë humbjen dhe mundësona largimin nga ajo!

*Ahsenul-Bejan min mevakif Ehlul-Iman
Ebu Islam, Salih ibën Ta Ha ABDULVAHID*

*Përshtati: Sabahudin SELIMI
Viti / Kosovë*



HYRJA NË TUALET DHE PASTRIMI PAS JASHTËQITJES ^[1]

“I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Kur të shkoni në vendin e kryerjes së nevojave personale, mos u ktheni nga kibla gjatë kryerjes së nevojës së madhe apo të vogël dhe as mos i ktheni shpinën asaj, por kthehuni nga lindja ose nga perëndimi.”

Nga Enes Ibën Maliku radijallahu anhu transmetohet se kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem (dëshironte të) hynte në WC, thoshte:

“Allahume inni eudhu bike minel hubuthi vel habaithi - O Zot! Unë të kërkoj mbrojtje prej të ligjve dhe të ligave!” Ai i kërkoi mbrojtje Allahut prej djajve meshkuj e femra.

Transmeton Buhariu, Muslimi, Ahmedi etj.

Autori Abdulganij el Makdesi, Zoti i Madhërishëm e mëshiroftë, kapitullin e pastërtisë e ka ndarë në tema dhe pas rregullave të abdestit dhe gjërave

të tjera, fillon me një temë që ka lidhje me pastërtinë, e cila është edukata e hyrjes në tualet dhe pastrimi nga jashtëqitja.

Rregullat që muslimanët duhet t'i mësojnë dhe t'i zbatojnë gjatë hyrjes në tualet dijetarët i kanë ndarë në:

1. Rregulla që lidhen me shqiptimin e lutjeve të caktuara para hyrjes në tualet dhe pas daljes dhe
2. Rregulla praktike se si duhet të veprojë besimtari gjatë hyrjes në tualet, qëndrimit në të dhe daljes nga tualeti. Sqarimi dhe rregullat për hyrjen në tualet tregojnë që Islami është pro-

[1] Ky artikull është koment i librit Ummdetul Ahkam të dijetarit Abdulganij El Makdesi rahimehullah.

gram gjithëpërfshirës i çështjeve jetësore, i cili ngërthen në vetvete të gjitha sferat e jetës gjatë shtegtimt drejt amshueshmërisë. Kjo sqaron se feja islame është e kompletuar, e përsosur, e mrekullueshme, rrezatuese, që përfaqëson natyrshmërinë e kristalizuar të krijesës njeri.

EDUKATA ISLAME NË TUALET

Islami ka rregulla të fuqishme se si duhet të veprojë njeriu për të kryer jashtëqitjen, si në vijim:

1. Vendi i posaçëm
2. Lutjet para dhe pas daljes nga vendi i jashtëqitjes^[2]
3. Edukata se si duhet ta kryejë jashtëqitjen
4. Kujdes i madh për ruajtjen nga papastërtia dhe kjo përfshin:
 - a) ruajtjen e trupit dhe rrobave nga papastërtia,
 - b) pastrimin e vendit ku kryhet jashtëqitja.

Enes ibën Maliku, sahabi i nderuar që ka lindur në Medinë, i ka shërbyer Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ai është prej sahabëve që kanë transmetuar shumë hadithe. Ai na ka treguar sjelljen e Profetit alejhi selatu ve selam, se si e ka kryer jashtëqitjen, duke na informuar se ai edhe para një veprimi të tillë e ka adhuruar Zotin duke kërkuar mbrojtje prej Tij dhe në të njëjtën kohë e ka mësuar ummetin

e tij. Teksti “idha dehale” ka kuptimin kur dëshiron të hyjë dhe nuk kuptohet kur të hyjë. Tek version i shkurtuar i Buhariut qëndron: “Idha erade en jed'hulel hala”

El hala është vendi ku kryhet jashtëqitja dhe kjo përfshin WC-në dhe vendet në natyrë, duke pasur parasysh që në këto vende njeriu duhet të ruhet nga shikimet.

Në lidhje me dhikrin që duhet thënë para hyrjes në WC, përveç kësaj që ka përmendur autori duhet thënë edhe BISMILAH, duke u argumentuar me hadithin: “Pengesë mes xhinnit dhe vendeve të turpshme të njeriut kur dëshiron të hyjë në WC është të thënët BISMILAH”.^[3]

Transmetohet nga Ebu Ejub el Ensari radijallahu anhu se ka thënë: “I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Kur të shkoni në vendin e kryerjes së nevojave personale, mos u ktheni nga kibla gjatë kryerjes së nevojës së madhe apo të vogël dhe as mos i ktheni shpinën asaj, por kthehuni nga lindja ose nga perëndimi.”* Ebu Ejubi thotë: “Kur shkua në Sham, i gjetëm nevojtoret të ndërtuara me drejtim nga Qabja, prandaj devijonim drejtimin gjatë kryerjes së nevojave personale dhe kur dilnim, i kërkonim falje Allahut të Madhëruar.”

Transmeton Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi etj.

Ky hadith duhet të sqarohet në dy as-

[2] Për lutjet para dhe pas daljes nga tualeti shikoni librin Mburoja e Muslimanit.

[3] Shiko librin Irvaul Galil, nr 50, nga dijetari i madh Muhamed Nasirudin Albani, Zoti e mëshiroftë.

pektet në vijim:

1. Përshtatshmëria e hadithit në lidhje me temën dhe

2. Rregullat dhe vendimet që posedon hadithi në fjalë.

Sa i përket përshtatshmërisë së hadithit me temën ku e ka vendosur autori, sqarohet se ky hadith tregon dhe kërkon se si të sillemi në WC; me një fjalë, edukatën që duhet të tregojë personi në tualet.

Sa i përket Ebu Ejub el Ensarit, ai është quajtur edhe Zejd. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem me migrimin në Medinë ka qëndruar në shtëpinë e tij derisa i është ndërtuar xhamia. Ebu Ejubi ka vdekur në luftën ku është tentuar çlirimi i Kostandinopojës (Stambollit).^[4]

Teksti “kur të shkoni në vendin e kryerjes së nevojave personale” përfshin çdo vend ku njeriu kryen nevojën, qoftë tualet, vend i ndërtuar apo natyrë.

Për tekstin “mos u ktheni nga kibla...” shumica e dijetarëve thonë se ka për qëllim Qaben, ndërsa Ibn Sirini thotë se me të kuptohet Qabja dhe Mesxhidul Aksaja. Mendimi i drejtë është siç mendojnë shumica e dijetarëve. Teksti “dhe as mos ia ktheni shpinën...” do të thotë se kthimi drejt Qabes me fytyrë apo të kthyerit e shpinës nga ajo gjatë kryerjes së nevojës është i ndaluar dhe ky tekst përforcon ndalesën.

Teksti “por kthehuni nga lindja apo perëndimi” përfshin vendet e globit të cilat nuk e kanë Qaben në drejtimin e lindjes apo perëndimit, siç është rasti i banorëve të Medinës dhe vendeve si ajo. Në këtë kuptim është edhe hadithi i cili flet për drejtimin e kibles, ku thuhet se ajo është mes lindjes dhe perëndimit. Këtu nuk hyjnë ato vende ku drejtimi i kibles është në drejtim të lindjes apo perëndimit.

Teksti “kur shkuaam në Sham...” na tregon se sa të kujdesshëm dhe vigjilentë ishin sahabët në praktikimin e porosive profetike. Praktika e tyre reflekton dashurinë, mençurinë, respektin për fjalët e Allahut të Plotfuqishëm dhe të të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem si dhe njohuritë e larta për fenë dhe mesazhin qiellor.

A I LEJOHET PERSONIT QË GJATË KRYERJES SË NEVOJËS TË KTHEHET NGA QABJA

Dijetarët në këtë çështje kanë rënë në mospajtim dhe nga mospajtimi i tyre shfaqen tetë mendime.

1. Nuk lejohet absolutisht që gjatë kryerjes së nevojës njeriu të drejtohet nga Qabja, gjithashtu as shpinën nuk duhet ta kthejë nga Qabja. Me termin absolutisht aludohet se është e ndaluar si në tualet ashtu edhe në natyrë. Të këtij mendimi janë Ebu Ejub Ensariu,

[4] Çlirimi i Stambollit ka ndodhur në vitin 1453 nga Sulltan Fatihu rahimehullah.

Ibrahim Nehaviu, Thevriu, Ahmedi sipas një transmetimi. Këtë mendim e ka zgjedhur edhe Ibn Tejmijje, Ibën Kajjimi dhe Ibën Hazmi. Edhe Albani mendon kështu dhe argument sjell edhe ndalesën që është transmetuar në lidhje me të pështyrët në drejtim të kibles. Ky është mendimi i saktë në këtë mesele.

2. I lejohet personit të drejtohet nga kibla qoftë në natyrë qoftë në tualet. Këtë mendim e ka Urvetu ibën Zubejri, Rabi'atu (mësuesi i Imam Malikut) dhe Davud Dhahiri.

3. Është mekruh për personin që të drejtohet nga kibla gjatë kryerjes së nevojës. I këtij mendimi është imam el Kasim Ibrahim.

4. Lejohet të drejtuarit drejt Qabes gjatë kryerjes së nevojës në tualet e nuk lejohet në natyrë. Të këtij mendimi janë shafitë, hanbelitë sipas një transmetimi, malikitë dhe një grup nga selefi.

5. Lejohet të kthyerit e shpinës drejt Qabes në tualet e jo që fytyra të jetë e kthyer në drejtim të Qabes. I këtij mendimi është Ebu Jusufi, nxënësi i Ebu Hanifes.

6. Nuk i lejohet personit të kthejë fytyrën nga Qabja dhe i lejohet të kthejë shpinën nga Qabja qoftë në tualet apo në natyrë. I këtij mendimi është Imam Ebu Hanife si dhe ka një transmetim nga Imam Ahmedi.

7. I ndalohet personit të kryejë nevo-

jën duke e kthyer fytyrën dhe shpinën drejt Qabes dhe Bejtul Makdisit. I këtij mendimi është Muhamed Ibën Sirini.

8. Ndalesa është vetëm për banorët e Medinës dhe ata që janë në drejtim si qyteti i Medinës, ndërsa për ata që kiblen e kanë në drejtim të lindjes apo perëndimit atyre u lejohet të kthejnë fytyrën dhe shpinën drejt Qabes si në tualet ashtu edhe në natyrë. I këtij mendimi është Ebu Auane.^[5]

Transmetohet nga Enes ibën Maliku radijallahu anhu se ka thënë: *"I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem hynte në tualet, ndërsa unë dhe një djalosh tjetër mbartnim një enë ujë dhe një shkop në dorë dhe ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pastrohej me ujë (pas jashtëqitjes)."*

Transmeton Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Nesaiu.

Enes ibën Maliku na informon se ai me një djalë tjetër i kanë ofruar Profetit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ujë për t'u pastruar nga jashtëqitja dhe po ashtu e kanë mbuluar vendin ku është kryer jashtëqitja për t'u ruajtur nga shikimet e kalimtarëve.

Çfarë përfitojmë nga hadithi

- Të lejuarit e pastrimit vetëm me ujë dhe kjo është më e mirë se të pastruarit vetëm me gurë, ngase uji është më pastrues.

Po ashtu është më mirë për pastrimin

[5] Shiko Nejlul Evtar 1/328 nga Imam Shevkani, botoi Daru Ibën el Xhevzi, Botimi i parë 1427h.

të fillohet me gurë e pastaj me ujë.^[6] Imam Neveviu, Zoti e mëshiroftë thotë: “Një grup nga të parët dhe të mëvonshmit prej dijetarëve si dhe konsensusi i hoxhallarëve të fetvasë thonë se më e pëlqyer për personin është që të bashkojë në pastrim ujin dhe gurin. Së pari përdor gurët për të larguar fëlliqësinë, ngase mbron dorën që të mos prekë fëlliqësinë, e pastaj përdor ujin. Nëse dëshiron personi të përdorë vetëm njërën prej tyre lejohet.

- Përgatitja për të kryer jashtëqitjen.
- Të siguruarit nga shikimi i të tjerëve.
- Hadithi motivon të vegjlit që të shërbejnë.

Transmetohet nga Ebu Katade (El Harith ibën Rib’ij) el Ensari radijallahu anhu se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “*Askush prej jush të mos e prekë organin e tij (gjenital) me dorën e djathtë gjatë urinimit dhe as të mos pastrohet me dorën e djathtë pas jashtëqitjes, as të mos marrë frymë në enë (kur pi ujë).*”

Transmeton Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu etj.

Ky hadith përfshin tri çështje edukative nga edukata profetike:

- 1) Mosprekja e organit gjenital me dorën e djathtë.
- 2) Mosprekja e ndyrësirës me dorën e djathtë.
- 3) Mosfryrja në enë.

Prekja e organit me dorën e djathtë është haram apo mekruh?

- 1) Mendimi i parë, sipas dhahirive, është se me këtë kuptohet se është haram.
- 2) Mendimi i dytë, sipas shumicës së dijetarëve, është se me këtë është për qëllim mekruhu.

Prekja e organit me dorën e djathtë, a është për qëllim vetëm gjatë urinimit apo në përgjithësi?

Disa mendojnë se ndalohet të prekurit e organit gjenital me dorën e djathtë edhe kur nuk je duke urinuar. Disa të tjerë mendojnë se qëllimi është vetëm kur urinohet, ashtu siç ka ardhur në hadith.

Çfarë përfitojmë nga hadithi?

- Ndalimi i prekjes së organit gjenital gjatë urinimit me dorën e djathtë.
- Ndalimi i pastrimit nga jashtëqitja me dorën e djathtë.
- Sqarimi se dora e djathtë është e nderuar dhe më e vlefshme se dora e majtë.
- Të treguarit rëndësi ndaj pastrimit në përgjithësi.

Adem AVDIU
Gjakovë / Kosovë

[6] Sot është lehtësim të përdorurit e letres në tualet, pra duke filluar me letër, pastaj me ujë dhe në fund me letër.



PASTRIMI DHE NAMAZI I TË SËMURIT

Nëse nuk mund të kërrusë kokën e as të bëjë shenjë me sy, atëherë falet me zemër. Tekbirin, leximin në këmbë, rukunë, sexhden dhe qëndrimin ulur e bën nijet me zemër dhe çdokush shpërblehet për atë që ka pasur nijet.

SI PASTROHET I SËMURI?

1 I sëmuri obligohet të pastrohet me ujë, domethënë merr abdest ose gusl.

2 Nëse nuk mund të pastrohet me ujë, qoftë për shkak të pamundësisë apo për shkak të frikës se mos i rëndohet sëmundja ose i vonohet shërimi, atëherë merr tejemum.

3 Tejemumi merret duke prekur tokën e pastër një herë me duar, më pas me duar përshkon fytyrën dhe shuplakat e duarve.

4 Nëse nuk mund të pastrohet vetë, atëherë abdestin ose tejemumin ia bën një person tjetër.

5 Nëse në disa gjymtyrë që përfshihen në abdest ka ndonjë plagë, ai duhet të provoj t'i lajë me ujë, por nëse larja me ujë e dëmton atë plagë, atëherë duhet që me dorë të lagur të bëjë mes'h mbi plagën. Nëse edhe mes'hi ia dëmton plagën, ai duhet të marrë tejemum.

6 Nëse disa gjymtyrë të të sëmurit janë të thyera dhe janë të lidhura me fashë apo në allçi, atëherë atyre gjymtyrëve duhet t'u japë mes'h në vend të larjes dhe

nuk ka nevojë të marrë tejemum sepse mes'hi e zëvendëson larjen e asaj pjese.

7 Lejohet të marrë tejemumin me prekje e murit apo ndonjë gjëje tjetër të pastër që ka pluhur sipër. Por nëse muri është i lyer me ndonjë materie që nuk i përket llojit të tokës, siç është ngjyra, atëherë të mos marrë tejemum me të, përveç nëse mbi atë mur ka pluhur.

8 Nëse tejemumin nuk mund ta bëjë me prekjen e tokës, murit apo diçkaje që ka pluhur sipër, atëherë s'ka gjë të keqe që ta vendosë dheun në ndonjë enë apo në shami dhe të marrë tejemumin me të.

9 Nëse merr tejemum për një namaz dhe pastaj nuk e prish atë deri në namazin vijues, atëherë namazin vijues e fal me po atë tejemum dhe s'ka nevojë që të marrë tejemum tjetër sepse ai vazhdon të jetë i pastër dhe nuk ka ndodhur diçka që ia prish tejemumin.

10 I sëmuri obligohet që ta pastrojë trupin e tij nga ndyrësitat, por nëse nuk mund të pastrohet, atëherë falet në atë gjendje dhe namazi i tij është i saktë dhe nuk obligohet ta përsërisë.

11 I sëmuri obligohet të falet në rroba të pastra dhe nëse i ndoten rrobat, ai obligohet t'i pastrojë apo t'i ndërrojë me të pastra. Por nëse nuk mund ta bëjë këtë, atëherë falet në atë gjendje, namazi i tij është i saktë dhe nuk obligohet ta përsërisë.

12 I sëmuri obligohet të falet në vend të pastër, por nëse ai vend ndotet,

atëherë obligohet pastrimi i atij vendi ose të shtrohet ndonjë gjë e pastër sipër tij. Por nëse kjo gjë nuk mund të bëhet, atëherë falet në atë gjendje, namazi i tij është i saktë dhe nuk obligohet ta përsërisë.

13 Të sëmurit nuk i lejohet ta vonojë faljen e namazit derisa t'i kalojë koha me arsyetimin se është i papastër, por duhet të pastrohet sipas mundësisë dhe të falë namazin në kohën e tij edhe nëse trupin apo rrobën e ka të papastër me ndonjë ndyrësi që nuk mund ta pastrojë.

SI FALET I SËMURI?

1 I sëmuri obligohet që namazin farz ta falë ngritur në këmbë, qoftë duke qëndruar i kërrusur apo i mbështetur në mur apo në shkop.

2 Nëse nuk mund të qëndrojë në këmbë, atëherë falet ulur dhe është më mirë që në pozitën e kijamit dhe rukusë të qëndrojë ulur këmbëkryq.

3 Nëse nuk mund të falet ulur, atëherë falet shtrirë në njërin krah, i drejtuar nga kibla dhe është më mirë të qëndrojë në krahun e djathtë. Nëse nuk mund të drejtohet nga kibla, atëherë falet në atë drejtim që ka trupin dhe namazi i tij është i saktë e nuk ka nevojë ta përsërisë.

4 Nëse nuk mund të falet shtrirë në njërin krah, atëherë falet shtrirë në shpinë duke i shtrirë këmbët në drejtim të kibles dhe është më e preferuar që

kokën ta ngrejë pak lart që të jetë e drejtuar nga kibla. Nëse nuk mund t'i shtrijë këmbët në drejtim të kibles, atëherë falet në atë drejtim që është shtrirë trupi i tij dhe namazi është i saktë e nuk ka nevojë ta përsërisë.

5 I sëmuri ka obligim që në namazin e tij të bëjë rukunë dhe sexhden, por nëse nuk mund t'i bëjë këto, atëherë e kërrus kokën duke bërë që në pozitën e sexhdes të jetë më tepër i kërrusur. Por nëse rukunë mund ta bëjë kurse sexhden jo, atëherë bën rukunë e plotë kurse në sexhde kërruset pak. Nëse sexhden mund ta bëjë por rukunë jo, atëherë sexhden e bën të plotë kurse në ruku kërruset.

6 Nëse nuk mund ta kërrusë kokën e tij në ruku dhe sexhde, atëherë bën shenjë me sy duke i mbyllur pak në rastin e rukusë, kurse në sexhde i mbyll më tepër. Ndërsa shenja me gisht, siç vepronë disa, nuk është e drejtë dhe nuk di ndonjë argument nga Kur'ani, Sunneti apo fjalët e dijetarëve që tregojnë për këtë.

7 Nëse nuk mund të kërrusë kokën e as të bëjë shenjë me sy, atëherë falet me zemër. Tekbirin, leximin në këmbë, rukunë, sexhden dhe qëndrimin ulur e bën nijet me zemër dhe çdokush shpërblehet për atë që ka pasur nijet.

8 I sëmuri ka obligim që çdo namaz ta falë në kohën e vet dhe çdo veprim që është i obliguar në namaz e kryen sipas mundësive që ka. Nëse e ka të vështirë që çdo namaz ta falë në kohën e vet, atëherë bashkon namazin e drekës me të ikindisë

dhe të akshamit me të jacisë, duke i bashkuar dy të parat në kohën e drekës ose ikindisë, kurse dy të fundit në kohën e akshamit ose jacisë, varësisht sipas lehtësisë për të. Kurse namazi i sabahut nuk bashkohet me ndonjë namaz para tij apo pas.

9 Nëse i sëmuri është duke u mjekuar jashtë vendit, atëherë namazet me katër rekate i shkurton në dy rekate, duke falur drekën, ikindinë dhe jacinë me nga dy rekate deri në kohën kur të kthehet në vendin e tij, qoftë nëse zgjat qëndrimi jashtë vendit apo është i shkurtër.

Muhammed ibën Salih el UTHEJMIN

*Përshtati: Jeton BOZHANI
Vushtrri / Kosovë*

www.ibnothaimeen.com